



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

STUDIMET POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

PUNIMI I MAGJISTRATURËS:

Tema:

“Aftësitë sociale dhe emocionale në funksion të përgatitjes së nxënësve për jetën”

Mentori:

Prof. Inord. dr. Demush Bajrami

Studentja:

Besarta Shabani

DEKLARATA E STUDENTIT

© [2021] - [Besarta Shabani] Të gjitha të drejtat e rezervuara

Unë Besarta Fadil Shabani deklaroj se këtë punim e kam kryer vetëm dhe pa ndihmën e ndonjë personi tjetër. Për të gjitha pjesët e marra në këtë punim i kam vendosur referencat dhe garantoj se këtë punim nuk e kam dorëzuar për t'u vlerësuar për ndonjë model tjetër. Gjithashtu materialet e marra nuk cenojnë të drejtën e autorit sepse çdo material është cituar në bazë të rregullave akademike, duke përdorur citate në referenca dhe literaturë.

Thesis:

“Social and emotional skills in order to prepare students for life”

Teza:

“Aftësitë sociale dhe emocionale në funksion të përgatitjes së nxënësve për jetën”

Теза:

**“Социјални и емоционални вештини во функција на подготовка на учениците
за живот”**

Mirënjohje

Së pari, shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim mbikëqyrësit dhe mentorit, Prof. Dr. Demush Bajrami për gatishmërinë për të më udhëhequr në rrugëtimin e studimeve, këshillat e tij të çmueshme, udhëzimet, për përkrahjen, profesionalizmin, inkurajimin, kohën dhe kritikën konstruktive që më ka dhënë gjatë gjithë këtij studimi kërkimor.

Së dyti, mirënjohëse u jam atyre që më qëndruan pranë gjithmonë gjatë këtij rrugëtimi, prindërve të mi, vëllezërve dhe të fejuarit tim. Mbështetja e tyre u bë motiv për mua për arritjen e këtij suksesi sepse pa mbështetjen e tyre nuk do të kisha arritur të përfundoj me sukses këtë cikël të dytë studimesh.

Së fundi, falënderoj drejtorin e institucionit në të cilin punoj Z. Jashar Jashari për bashkëpunimin gjatë tërë kësaj periudhe, kolegët e mi dhe të gjithë pjesëmarrësit që u bënë pjesë e hulumtimit tim. Gatishmëria e tyre për të kontribuar dhe mbështetur ka bërë që ky studim të realizohet ashtu siç e kisha planifikuar duke më ndriçuar rrugën me mendimet dhe rekomandimet e tyre profesionale.

Përmbledhje

Në procesin arsimor një nga aspektet më të rëndësishme është formimi i personalitetit të nxënësve, i cili në vete përfshin edhe zhvillimin social dhe emocional që nga lindja.

Ky punim ka për qëllim të japë një përshkrim të qartë të zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve. Fokusi dhe objektivat e punimit nxjerrin në pah zhvillimin dhe ndikimin e këtyre aftësive në formimin jetësor të nxënësve dhe suksesin e tyre gjatë jetës.

Përgatitja e nxënësve për jetën është një proces i gjatë i cili në vete përfshin sfida të shumta nëpër të cilat do të kalojnë nxënësit gjatë formimit të tyre. Ky proces fillon që pas lindjes së tyre, pikërisht në gjirin familjar e pastaj vazhdon duke u zhvilluar sipas fazave të pjekurisë.

Arritja e suksesit nga nxënësit gjatë jetës së tyre varet nga kujdesi i prindërve, mënyra e bashkëpunimit me rrethin shoqëror, dashuria dhe respektimi i tyre dhe ofrimi i barazive për të gjithë.

Interesimi për zhvillimin e aftësive të nxënësve si burim mbështetje për përgatitjen për jetë kanë qenë çështje diskutimi i shumë prindërve, mësimitdhënësve, psikologëve, analistëve në vende të ndryshme të botës, me qëllim të gjetjes së mënyrës adekuate për zhvillimin e duhur të fëmijëve.

Për këtë temë u organizuan diskutime të hapura, konferenca, trajnime e madje disa vite më parë, në Kosovë, u bë edhe hartimi i kurrikulës, duke ngritur lart rëndësinë që duhet kushtuar zhvillimit të fëmijëve për përgatitjen për jetë.

Në këtë studim janë përdorur metodat e të dhënave përshkruese, sasiore dhe metoda krahasuese, duke e bërë më të lehtë punën e analizës së të dhënave të cilat janë mbledhur me ndihmën e pyetësorëve të standardizuar nga mësimitdhënësit e shkollave fillore në Kosovë. Paraqitjen e tyre është bërë edhe në mënyrë vizuale – grafike, përmes tabelave dhe grafikëve, me qëllim të paraqitjes së rëndësisë së temës së punimit.

Fjalët kyçe: zhvillim, aftësi sociale - emocionale, nxënës, përgatitje, jetë

Апстракт

Во образовниот процес еден од најважните аспекти е формирањето на личноста на учениците, што само по себе го вклучува социјалниот и емоционалниот развој од самото раѓање.

Овој труд има за цел да даде јасен опис за развојот на социјалните и емоционалните вештини кај учениците. Фокусот и целите на трудот го истакнуваат развојот и влијанието на овие вештини врз формирањето за живот кај учениците и нивниот успех во текот на животот.

Подготовката на учениците за живот е долг процес кој сам по себе вклучува многу предизвици низ кои учениците ќе поминат во текот на нивното формирање. Овој процес започнува по нивното раѓање, токму во семејството и потоа продолжува да се развива според фазите на зрелост.

Постигнувањето на успехот на учениците во текот на нивниот живот зависи од грижата на родителите, начинот на соработка со општествениот круг, нивната љубов и почит и обезбедување еднаквост за сите.

Интересот за развивање на вештините на учениците како извор на поддршка за подготовка за живот е предмет на дискусија на многу родители, наставници, психолози, аналитичари во различни делови на светот, со цел да се најде адекватен начин за правилен развој кај децата. .

На оваа тема беа организирани отворени дискусии, конференции, обуки и уште пред неколку години во Косово беше изготвен наставниот план со што се подигна важноста што треба да и се даде на развојот кај децата во подготовка за живот.

Во оваа студија беа користени дескриптивни, квантитативни и компаративни методи на податоци, со што се олеснува работата на анализа на податоците, кои беа собрани со помош на стандардизирани прашалници од наставниците од основните училишта во Косово. Нивната презентација се врши визуелно - графички, преку табели и графикони, со цел да се прикаже важноста на темата на трудот.

Клучни зборови: развој, социјално-емоционални вештини, студенти, подготовка, живот

Abstract

In the educational process one of the most important aspects is the formation of students' personality, which in itself includes social and emotional development from birth.

This paper aims to provide a clear description of the development of students' social and emotional skills. The focus and objectives of the paper highlight the development and impact of these skills on students' life formation and their success throughout life.

Preparing students for life is a long process which in itself includes many challenges that students will go through during their formation. This process begins after their birth, exactly in the family and then continues to develop according to the stages of maturity. Achieving success by students during their lives depends on the care of parents, the way of cooperation with the social circle, their love and respect and providing equality for all.

The interest in developing students' skills as a source of support for life preparation has been the subject of discussion of many parents, teachers, psychologists, analysts in different parts of the world, in order to find an adequate way for the proper development of children.

On this topic, open discussions, conferences, trainings were organized and even a few years ago, in Kosovo, the curriculum was drafted, raising the importance that should be given to the development of children for the preparation for life.

In this study, descriptive, quantitative and comparative data methods were used, making the work of data analysis easier, which were collected with the help of standardized questionnaires by primary school teachers in Kosovo. Their presentation is done visually - graphically, through tables and graphs, in order to present the importance of the topic of the paper.

Key words: development, social-emotional skills, students, preparation, life

Përmbajtja

Mirënjohje.....	4
Përmbledhje.....	5
Анстракт	6
Abstract.....	7
Kreu I.....	9
1.0 Hyrje.....	9
Kreu II.....	10
2.0 Rishikimi i literaturës	10
2.1 Zhvillimi i personalitetit të nxënësve	10
a) Zhvillimi social.....	12
b) Zhvillimi emocional	14
2.2 Zhvillimi i aftësive sociale – emocionale.....	16
2.3 Gjithëpërfshirja sociale e nxënësve	19
2.4 Mësimi social – emocional.....	22
2.5 Vështirësitë në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale tek nxënësit.....	23
2.6 Metodatat dhe teknikat për zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale tek nxënësit.....	26
Kreu III.....	29
3.0 Metodologjia e hulumtimit.....	29
3.1 Objektivat e hulumtimit.....	29
3.2 Hipoteza	29
3.3 Analizat e të dhënave, prezantimi i rezultateve dhe diskutimi	30
3.1.1 Rezultatet nga pyetësi	30
3.2 Kufizimet	52
Kreu IV.....	52
4.0 Përfundimet dhe rekomandimet.....	52
4.1 Përfundime	52
4.2 Përmbledhje e rekomandimeve.....	53
Referenca	54
Shtojca:	57
Pyetësi	57

Kreu I

1.0 Hyrje

Shkolla është një komunitet që si qëllim kryesor ka edukimin e brezave të rinjë. Edukimi i nxënësve ndryshon nga nxënësi në tjetrin, sepse çdo nxënës është unik. Mënyra e jetesës, gjendja ekonomike, arsimimi i prindërve, kujdesi i prindërve ndaj fëmijës, rrethi shoqëror, janë faktorët kryesor të cilët ndikojnë në zhvillimin social dhe emocional tek nxënësit dhe arritjet e tyre. Zhvillimi i nxënësve në vete përfshin zhvillimin social dhe emocional, i cili në vazhdimësi tregohet si pasqyrë e mënyrës së ndërtimit të personalitetit të nxënësve.

Procesi i zhvillimit të njeriut nuk mund të mendohet pa një shoqëri, prandaj është shumë e rëndësishme që zhvillimi i mirëfilltë i fëmijëve të fillojë të zhvillohet që në moshë të hershme dhe në mënyrën e duhur. Hapat e parë të zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale merren në familje e më pas ato vazhdojnë dhe përforcohen në kopshte, çerdhe, shkolla e gjatë tërë jetës së një individi. Një zhvillim i mirëfilltë i aftësive sociale dhe emocionale bënë që nxënësit të mos kenë vështirësi në integrimin në shoqëri, të pranojnë mjedisin shoqëror me lehtësi, të krijojnë miq të rinjë dhe të socializohen me të tjerët.

Ndërlidhje e mirë e procesit të socializimit të nxënësve dhe shprehja e tyre emocionale konsiderohet puna në grupe si një ndër metodat shumë të përdorura në institucionet shkollore edukativo - arsimore. Puna në grupe është shumë e rëndësishme në zhvillimin e fëmijëve. Kjo metodë e punës u ndihmon fëmijëve duke iu ofruar shumë përfitime sepse u mundëson njohjen më mirë të njëri - tjetrit, socializohen në mënyrë të vazhdueshme, të fillojnë të shprehin emocionet lirshëm, të ndajnë detyrat dhe fitojnë ndjenjën e përgjegjësisë për detyrat që iu takojnë.

Sot në shkollat tona mësimdhënësit kanë filluar të shtojnë kujdesin e arsimimit të nxënësve duke u fokusuar në zhvillimin social dhe emocional të tyre. Përdorin metoda, teknika dhe strategji adekuate përmes mësimi social – emocional dhe arrijnë të nxisin zhvillimin e aftësive të nxënësve duke i përgatitur ata për jetën.

Kreu II

2.0 Rishikimi i literaturës

2.1 Zhvillimi i personalitetit të nxënësve

Socializimi është procesi me të cilin njerëzit mësojnë karakteristikat e normave të grupit të tyre, vlerat, qëndrimet dhe sjelljet. Pra është personaliteti ynë që na bën atë që jemi.

Zhvillimi i personalitetit i referohet mënyrës se si shfaqen modelet e organizuara të sjelljes që përbëjnë personalitetin unik të secilit person gjatë kohës. Ekzistojnë shumë faktorë që ndikojnë në zhvillimin e personalitetit, duke përfshirë gjenetikën, mjedisin, prindërit dhe ndryshimet shoqërore. Zhvillimi i personalitetit fillon herët në jetën e nxënësve dhe është një pasqyrim i vërtetë i qenies së tyre të brendshme.

Në zhvillimin e personalitetit të nxënësve padyshim që përfshihen edhe zhvillimi i aftësive sociale dhe emocionale. Sipas Ylli Zhurda në librin e tij Psikologjia, thotë se: “Me personalitet kuptojmë modelet e dallueshme të sjelljes, qëndrimeve, mendimeve, motiveve dhe emocioneve që karakterizojnë një njëri në situatë të ndryshme dhe që janë të qëndrueshme në kohë” (Zhurda, Psikologjia, 2009).

“Në këtë përkufizim të personalitetit bëhet fjalë për ato modele që e dallojnë një individ nga të tjerët dhe që janë relativisht të qëndrueshme, pra nuk janë të momentit apo që varen nga situatat” (Zhurda, Psikologjia, 2009, f. 198). Nisur nga përkufizimi kuptojmë së çdo nxënës është i ndryshëm sepse ai është unik.

Në zhvillimin e duhur të aftësive të nxënësve rol luan edhe shkolla.

“Arsyeja dhe kuptimi i ekzistimit të shkollës është mësimi. Leksionet janë pjesë e veçantë e interakcionit të nxënësve me mësuesit e tyre, ndërsa shkolla shtë vend specifik ku manifestohen të gjithë interakcionet e ndërsjellta” (Jashari, 2005, f. 132).

Formimi i personalitetit lidhet ngushtësisht me faktorët social. “Personaliteti është dukuri jo vetëm psikologjike por edhe sociale, se ai është rrjedhim i ndikimeve të faktorëve social mbi bazën e të dhënave biologjike” sipas (Hoti, 2012, f. 24).

Faktorët social janë të shumtë duke filluar nga familja dhe kushtet e saj në të cilat rritet fëmija, shkolla, grupi i moshatarëve, kushërinjtë, literatura që lexon, filmat që shikon, marrëdhëniet me të tjerat... Personaliteti i nxënësve formohet nën ndikimin e familjes, së pari nga nëna dhe edukimit të saj e pastaj nga mjedisi dhe shoqëria ku ai jeton.

“Me identitet personal nënkuptohet ajo sesi njeriu ndjehet si person. Përjetimi i tillë fillon qysh në periudhën e gji dhënies dhe varet nga ajo se në çfarë mase marrëdhëniet që fëmija i realizon me të rriturit në afërsinë tuaj (me prindërit, edukatorët) janë të bazuara në besim, që më tej e fuqizojnë ndjenjën e sigurisë të fëmija. Formimi i identitetit është një proces i vazhdueshëm. Kur themi se fëmija ka krijuar pasqyrë pozitive për veten e tij, kjo do të thotë se ai e njeh dhe e respekton emrin e tij, gjininë, pozicionin e tij në familje, pamjen fizike, etninë, aftësitë dhe mungesat, si dhe gjuhën që e flet.” (Shehu, F. Pallçevska, S, 2014, f. 46)

“Zhvillimi i personalitetit varet nga gjendja mendore, fizike dhe intelektuale”. (Dubey, 2017, f. 2) Jo të gjithë nxënësit kanë zhvillim të mirëfilltë, të jenë të shëndoshë si mendërisht ashtu dhe fizikisht. Në ditët e sotme kemi kategori të ndryshme të nxënësve të pranishëm në shkollat tona dhe vërejmë që zhvillimi i tyre ndryshon tek secili. Disa kanë zhvillim normal e disa të tjerë disa probleme në zhvillimin e personalitetit të tyre nisur nga faktorë të ndryshëm.

Në librin “Zhvillimi i personalitetit” autori anglez Dubey, tregon edhe ndikimin e faktorëve të cilët ndikojnë në personalitetin e nxënësve duke filluar nga: trashëgimia, paraqitja e përgjithshme, kultura, përvoja, edukimi dhe trajnimi.

Faktorë të tjerë që ndikojnë në zhvillimin e personalitetit janë edhe gjendja e vështirë ekonomike, kequshqyerja e nxënësve, punët e detyrueshme të cilat duhet t’i bëjnë e ndonjëherë edhe ndarja sipas shtresave shoqërore të shoqërisë.

“Shoqëritë vazhdojnë të ndahen ashpër midis shtresave shoqërore për shkak të racës, etnisë dhe paragjykimet fetare të qytetarëve të tyre. Mundësitë e njerëzve për pjesëmarrje të plotë në jetën shoqërore varen nga vendi ku kemi lindur dhe arsimuar” (Shabani A., Bajrami D., 2019, f. 258).

Përveç këtyre zhvillimi i një personaliteti shquhet për tri momente domethënëse të cilat janë: qëndrueshmëria, uniteti dhe veçantia.

“Çdo personalitet shquhet me tri momente domethënëse për të:

Qëndrueshmëria (konsekuenca): Personaliteti pasqyron prirjen e individit që në situata të ngjashme të manifestojë sjellje të ngjashme. Dikush është i sinqertë, modest, ambicioz dhe këmbëngulës (i devotshëm), dhe gjithë këto tipare i shfaq në sjelljen e tij, ashtu siç e njohim.

Uniteti (integriteti): Të gjitha proceset dhe tiparet janë të integruara brenda një personaliteti.

Gjendja e përgjithshme, në të cilën ndodhet personaliteti, në një moment konkret, do të reflektohet te proceset dhe tiparet që përbëjnë atë.

Veçantia: Secili individ është i veçantë dhe i papërsëritshëm. Kur themi se një individ është i veçantë duam të theksojmë se ai ndryshon prej të tjerëve në bazë të asaj se çfarë tipare e karakterizojnë atë dhe si ata janë të ndërlidhura midis vete.” (Murtezani, 2014, f. 129)

Zhvillimi i personalitetit fillon herët në jetën e një nxënësi dhe është një pasqyrim i vërtetë i qenies së tyre të brendshme. Gosala, për zhvillimin e personalitetit thotë se mund të përkufizohet si një grup tiparësh që formojnë qenien e brendshme dhe të jashtme të një personi me model të organizuar sjelljeje që e bën një person të dallueshëm. Karakteri, sjellja, qëndrimi dhe mjedisi janë disa nga cilësitë që formojnë personalitetin e një individi. Ndihej në fitimin e besimit, vetëbesimit, ndikimit pozitiv në aftësitë e komunikimit dhe mënyrën se si e sheh botën. Nxënësit duhet të zhvillojnë një personalitet tërheqës dhe mbresëlënës që do të rrisë cilësinë e të mësuarit.

a) Zhvillimi social

“Zhvillimi social ka të bëjë me aspektin si fëmija ndërvepron me personat e tjerë (prindërit, kujdestarët parësor, edukatorët, familjarët, moshatarët dhe të rriturit e tjerë) dhe si ndërveprimet me personat e tjerë ndikojnë në zhvillimin e tij/saj. Zhvillimi social i ndihmon fëmijës të njohë mjedisin social që e rrethon, mjedisin kulturor dhe traditën, si dhe të zhvillojë kuptimin për komunitetin. Sjellja e hershme sociale ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga praktikat e prindërve për rritjen e fëmijëve, duke përfshirë mënyrën se si prindërit realizojnë zbatimin e rregullave, si japin ndihmën dhe nxitjen fëmijës së tyre.” (MASHT, Standardet e zhvillimit dhe të mesuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet, 2011)

“Zhvillimi social sipas revistës New Nouveau Brunswick Kanada, ka të bëjë me përmirësimin e mirëqenies së çdo individi në shoqëri në mënyrë që ata të arrijnë potencialin e tyre të plotë” (New Brunswicker, 2008). Suksesi i shoqërisë është i lidhur me mirëqenien e çdo qytetari. Zhvillimi social nënkupton investimin tek njerëzit dhe kërkon heqjen e barrierave kështu qytetarët udhëtojnë drejt ëndrrave që kanë me besim dhe dinjitet.

Çdo fëmijë duhet të ketë mundësinë të rritet, të zhvillojë aftësitë e veta dhe të kontribuojë në familjet dhe komunitetet e tyre. Nëse ata janë të shëndetshëm, të arsimuar mirë dhe të trajnuar për të hyrë në fuqinë punëtore ata janë të pajisur më mirë për të përmbushur nevojat e tyre themelore pastaj jo vetëm familjet e tyre por e gjithë shoqëria do të përfitojë.

Mësimi i fëmijëve duhet të fillojë herët në jetën e tyre. Sigurimi që fëmijët të kenë një fillim të mirë në edukimin e tyre shkon për të rritur suksesin e tyre më vonë në jetë. Por çdo gjë lidhet me kushtet në familje, kujdesi i anëtarëve të familjes ndaj fëmijëve dhe të tjerëve, arsimimi i tyre dhe jeta e tyre e shëndetshme që bëjnë.

“Nocioni aftësi është bërë në bazë të dallimeve në suksesin e njerëzve që punojnë në rrethana të njëjta objektive dhe të cilët njësoj gjatë janë aftësuar për punën e caktuar. Ato dallime paraqiten edhe atëherë kur, me faktorët e përmendur, edhe synimet e njerëzve që të arrijnë sukses janë të njëjta”. (Haskovic, 2006, f. 80)

Duke pasur parasysh faktin që ato dallime në sukses të njerëzve paraqiten edhe atëherë kur ata janë të barazuar edhe për nga përvoja, nga nocioni aftësi duhet përjashtuar dijet, shkathtësitë dhe karakteristikat e tjera të fituara përmes aktivitetit të caktuar.

Aftësitë sociale janë aftësitë që ne përdorim çdo ditë për të bashkëvepruar dhe komunikuar me të tjerët. Ato përfshijnë komunikimin verbal dhe jo verbal, të tilla si të folurit, gjestet, shprehjet e fytyrës dhe gjuhën e trupit. Një nxënës ka aftësi të forta shoqërore nëse ka njohuri se si të silllet në situata shoqërore dhe kupton rregullat e shkruara dhe të nënkuptuara kur komunikon me të tjerët.

“Zhvillimi social dhe ndërveprimi me të tjerët ndikojnë te fëmija për mënyrën se si ai sheh veten, të tjerët dhe botën që e rrethon. Nëpërmjet zhvillimit social, fëmija njeh mjedis social e kulturor që e rrethon, vlerëson komunitetin në të cilin jeton dhe kontribuon në mbarëvajtjen e jetës së përbashkët në këtë komunitet”. (Gerti Janaqi A. Z., Standardet e zhvillimit dhe të të nxënës të fëmijëve 3-6 vjeç, 2015, f. 41)

Edhe kultura e shkollës ndikon në zhvillimin e fëmijëve.

“Kultura e shkollës është koncept i fuqishëm për komunikimin e shkollës me rrethin. Shikuar nga aspekti i sociologjisë së arsimit, shkolla duhet t'i kushtojë kujdes imazhit të saj, veçmas vlerave të veçanta të cilat e krijojnë autoritetin e saj në shoqëri” (Jashari, 2005, f. 107).

Zhvillimi social vazhdon të zhvillohet gjatë gjithë fazave të jetës së një njeriu. “Duke filluar prej moshës 6 gjer në 10 vjeç, mbi zhvillimin social dhe personalitetin e fëmijës, përveç familjes ndikojnë edhe faktorë të tjerë të shumtë. Shkollat, kishat, klubet dhe shtypi – të gjitha këto ushtrojnë ndikimin e tyre”. (Pettijohn, 1996, f. 86)

Zhvillimi i fëmijëve vazhdon edhe gjatë fazës së adoleshencës. “Standardet sociale lozin një rol të madh në jetën e adoleshentit. Disa shoqëri kanë përpunuar ceremonitë e “riteve të kalimit” që mund t’u sjellin adoleshentëve statusin komplet dhe të menjëhershëm të të rriturit, si para syve të tyre ashtu edhe para shoqërisë”. (Pettijohn, 1996, f. 96)

b) Zhvillimi emocional

“Emocionet thuhet se janë gjuha jonë e parë, pasi që në momentet e para të jetës qenia njerëzore fillon të komunikoj emocionalisht nëpërmjet një akti të tillë siç është të qarit.” (Orhani, 2011, f. 103) Kështu kjo është forma e parë e komunikimit të fëmijës më të rriturin e cila shprehet përmes emocioneve dhe formës së të qarit.

Emocionaliteti është pjesë e pandarë e botës shpirtërore. Ai konsiderohet si një mekanizëm i disponueshëm nga organizmi për të përballuar me sukses situatë apo stimuj që vijnë nga ambienti brenda ose jashtë individit.

“Emocionet përcjellin dhe janë pjesë përbërëse e sjelljes dhe e përjetimit të njeriut.

Ne për çdo ditë, në çdo moment përjetojmë, më pak ose më shumë ndjenja të fuqishme të gëzimit, të pikëllimit, të dashurisë, të ngushëllimit, të simpatisë, të krenarisë, të dashaligësisë, të mendjemadhësisë, të turpmit, të falënderimit, të brengosjes, të frikës, të pritjes, të shpresës etj. Të gjitha këto dhe shumë ndjenja të tjera që i përjeton njeriu, janë të lidhura me objekte, persona ose situatë të caktuara që janë shkas i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i atyre përjetimeve”. (Haskovic, 2006, f. 68)

Zhvillimi emocional përbën një fushë të rëndësishme të funksionit dhe zhvillimit fizik dhe kognjitiv. “Aftësia për të interpretuar apo shpjeguar reagimin emocional personal apo të një tjetri është një aftësi themelore për marrëdhëniet interpersonale”. (Profka I. A., 2017)

“Në zhvillimin e hershëm fëmijët bëhen të vetëdijshëm për gjashtë emocionet bazë: i zemëruar, i mërziur, i frikësuar, i dashuruar dhe i surprizuar, dhe në zhvillimin emocional ndodh një tranzicion në aftësitë e fëmijëve për të identifikuar dhe përcaktuar emocionet e veta dhe ato të tjerëve“. (Profka I. A., 2017)

Sipas Laraformm, “Zhvillimi emocional i një fëmije i bën ata të vetëdijshëm për origjinën dhe zhvillimin e emocioneve të tyre. Ata fillojnë t'i lexojnë ato në shprehjet e fytyrës së njerëzve të tjerë, dhe kështu t'i interpretojnë ato në përputhje me kontekstin shoqëror. Ndryshimi dhe rritja e pritur prej tyre në një nivel emocional buron nga dy fusha. Nga njëra anë, nga përvojat që ndodhin në kontekstin e tyre dhe nga ana tjetër, nga pjekuria e tyre” (Laraformm).

Kjo është arsyeja pse ata fillojnë të vendosin qëllime të caktuara emocionale në lidhje me veten dhe të tjerët. “Ata e bëjnë këtë duke marrë parasysh kontekstin dhe situatën. Mënyra në të cilën fëmijët shfaqin lloje të ndryshme të emocioneve ndryshon shumë në varësi të përvojave të tyre të kaluara. Ajo gjithashtu ka shumë të bëjë me historinë e tyre të të mësuarit. Kjo, si rezultat, çon në arritje të rëndësishme në të kuptuarit, rregullimin emocional dhe reagimin empatik” (Laraformm).

Çdo fëmijë dallon njëri nga tjetri për shkallën e inteligjencës emocionale të cilën e posedojnë. “Fëmijët me inteligjencë emocionale të fortë kanë aftësi të kuptojnë shumë mirë ndjenjat e të tjerëve, të kuptojnë më mirë veprimet dhe qëndrimet e tyre dhe të kenë një ndërveprim më të suksesshëm. Nga ana tjetër, fëmijët me inteligjencë emocionale të dobët, nuk janë në gjendje të përcaktojnë problemet sociale që kanë të tjerët, ndaj edhe kanë shumë vështirësi në ndërveprimin e tyre me të tjerët” (Musa Kraja, 2017, f. 22)

Për të rritur një fëmijë të suksesshëm, Gëzim Dibra kishte thënë: “Është e rëndësishme të krijohet një harmoni mes forcës së zemrës dhe forcës së mendjes dhe çelësi këtu është dhembshuria. Kur fëmija ka probleme në sjellje, probleme sociale apo emocionale me të tjerët në shkollë me shokët apo fqinjët, atëherë ne duhet të kemi kujdes, duhet të themi se kemi probleme me dhembshurinë tek ky fëmijë”.

2.2 Zhvillimi i aftësive sociale – emocionale

Zhvillimi i aftësive sociale – emocionale edhe pse është tejet i rëndësishëm është proces i vështirë të zhvillohet tek fëmijët gjithmonë me ndihmën e familjes dhe të rriturve. Organizata të ndryshme botërore, besojnë se ndihma e të rriturve në zhvillimin e aftësive të tyre sociale-emocionale u lejon atyre të mbështesin, angazhohen dhe mësojnë këto aftësi kritike të jetës dhe u ndihmojnë atyre që të përballen me jetën e përditshme pasi që askush nuk lind me këto aftësi por që ato zhvillohen gradualisht gjatë fazave të jetës.

“Ne nuk kemi lindur me aftësi social-emocionale. Ato formohen në fëmijëri, kultivohen gjatë gjithë jetës sonë dhe mund të vazhdojnë të rriten dhe evoluojnë. Prandaj, në mënyrë që fëmijët të mësojnë dhe të jenë dëshmitarë të mësimin social-emocional, ai duhet të fillojë me të rriturit.” (Lovins, 2018)

Sipas Jessica Lovins, procesi i trajnimit dhe mbështetjes së të rriturve duhet të jetë i qëllimshëm. Duke ofruar trajnime të vazhdueshme dhe mundësi zhvillimi profesional të rrënjësura për mësimin social - emocional, ne sfidojmë dhe mbështesim stafin tonë që të përqendrohet në aftësitë e tyre sociale-emocionale. Kur të rriturit kuptojnë zhvillimin e tyre social - emocional, ata pastaj mund ta fusin atë në mënyrë refleksive në çdo ndërveprim me fëmijët dhe me njëri-tjetrin.

“Për zhvillimin emocional tek fëmijët ka rëndësi të madhe rrethi ku jetojnë dhe posaçërisht atmosfera në familje. Nëse rrethi ku fëmiju jeton është e mirë dhe e qetë, tek fëmijët më shumë do të shfaqet lumturia dhe dashuria, ndërsa nëse jeton në një atmosferë jo të këndshme familjare, tek fëmiju do të ketë shfaqje më të shpeshtë të zemërimit, hidhërimit, frikës dhe nuk do të jetë i lumtur.” (Prof.asoc.dr.Illir Kelmendi, 2018, f. 14)

Zhvillimi social dhe emocional nuk është i njëjtë tek të gjithë fëmijët, ndryshon tek secili. Duke bashkëvepruar me të tjerët fëmijët mësojnë të bashkëpunojnë, të marrin përvoja të reja për jetën e tyre, të kuptojnë emocionet e shokut/shoqes, të mësojnë për përgjegjësitë duke u ndihmuar atyre të zhvillohen në mënyrë sociale dhe emocionale. Ky bashkëveprim u ndihmon që të mos kenë frikë, të rrisin vetëbesimin për të tejkaluar situatat jetësore dhe të shprehin ndjenjat e tyre.

“Zhvillimi social dhe emocional i fëmijës është një fushë e veçantë e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, e cila së bashku me fushat e tjera të zhvillimit luan rol të

rëndësishëm në procesin e formimit të personalitetit të fëmijës dhe të përgatitjes së tij/saj për procesin e shkollimit.” (Arjan Kamburi, f. 24)

“Zhvillimi emocional dhe social përfshin aktivitetet që fokusohen në dhënien e ndihmës për fëmijët në krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira shoqërore me miq të rinj dhe të vjetër, të shkojë mirë me të tjerët, të menaxhojë emocionet, të shprehë vetveten, të ketë dëshirë të mësojë gjëra të reja, të fillojë dhe të mbarojë një aktivitet, të marrë përgjegjësi për veprimet dhe sjelljet që kryen.” (Gerti Janaqi A. Z., Standardet e zhvillimit dhe të të nxëniet të fëmijëve 3-6 vjeç, 2015, f. 39)

Sipas Clarke, “Ekzistojnë një sërë mënyrash të ndryshme të përcaktimit dhe matjes së aftësive sociale dhe emocionale dhe deri më sot ka munguar konsensusi rreth gjuhës dhe përkufizimeve. e përcaktuar shoqërore të mësuarit emocional si proces i marrjes së kompetencave bazë për të njohur dhe menaxhuar emocionet, vendosni dhe arrini qëllime pozitive, vlerësoni perspektivat e të tjerëve, vendosni dhe mbani marrëdhëniet pozitive, marrin vendime të përgjegjshme dhe trajtojnë situatat ndërpersonale në mënyrë konstruktive” (Clarke, Morreale, Field, Hussein, & Barry, 2015).

“Sipas Bashkëpunimi për Mësimin Akademik, Social dhe Emocional (CASEL) në Shtetet e Bashkuara, afërsia qëllimet e programeve të bazuara në aftësitë sociale dhe emocionale janë të nxisin zhvillimin e pesë grupeve të ndërlidhura të kompetencave njohëse, afektive dhe të sjelljes: vetëdije, vetë-menaxhim, vetëdije shoqërore, aftësitë e marrëdhënieve, dhe vendimmarrja e përgjegjshme.” (Clarke, Morreale, Field, Hussein, & Barry, 2015, f. 16).

“Aftësitë sociale dhe emocionale janë një pasuri dhe burim kryesor për zhvillimin pozitiv të të rinjve. E sinteza e gjetjeve nga ky rishikim mbështet rastin për një fokus të qëndrueshëm të politikave në ofrimin e niveleve të larta ndërhyrje cilësore për të rinjtë në të gjithë shkollën dhe mjediset jashtë shkollës. Studimet e vlerësimit në Mbretërinë e Bashkuar do të forcojnë bazën e provave për ankorimin e programeve dhe nismave efektive në politikat që mbështesin zhvillimin pozitiv të fëmijëve dhe të rinjve gjatë gjithë jetës dhe do të lehtësojnë qëndrueshmëria dhe integrimi i praktikave efektive.” (Clarke, Morreale, Field, Hussein, & Barry, 2015, f. 14)

Në librin “Standardet e zhvillimit dhe të të nxëniet të fëmijëve 3-6 vjeç” thuhet që “Zhvillimi social dhe emocional është i rëndësishëm për fëmijën për të nisur një jetë sociale të shëndetshme, për të hyrë në marrëdhënie me të tjerët dhe për të pasur një ndërveprim pozitiv me bashkëmoshatarët dhe të rriturit. Krijimi i marrëdhënieve të shëndetshme, zhvillimi emocional

dhe menaxhimi i sjelljeve dhe veprimeve të nxituara në situata e kontekste të caktuara janë aftësi që duhen zhvilluar me fëmijët parashkollorë. Në këtë fazë fillon edhe pranimi i detyrave në mënyrë individuale dhe grupore” (Gerti Janaqi A. Z., 2016).

“Pranimi dhe bërja e detyrave dhe punëve individuale dhe në grup ngrisin përgjegjësinë individuale dhe kolektive, shtojnë ndjenjën e sigurisë, meqë krijojnë kushtet dhe rrethanat për krijimin e atmosferës së përvetësimit të ndërsjellë” (Brada, 2010, f. 383)

“Zhvillimi socio-emocional konsiderohet si domeni më i rëndësishëm në zhvillimin e hershëm të fëmijëve, sepse ai e prek zhvillimin e të gjitha domeneve të tjera, ndërsa veçmas konsiderohet i rëndësishëm në raport me vendosjen e qasjes pozitive ndaj mësimin, ndaj përvetësimin të kompetencave akademike, jo vetëm në periudhën e fëmijërisë, por edhe më vonë në jetë” (Florina Shehu S. P., 2014, f. 37)

“Zhvillimi social–emocional është aftësia e fëmijëve për të kuptuar ndjenjat e të tjerëve, për të kontrolluar ndjenjat e tyre dhe për t’i shprehur ato. Që fëmijët të kenë aftësi të bashkëpunojnë, t’iu kushtojnë vëmendje apo të ndjekin udhëzime të caktuara duhet të kenë disa aftësi social – emocionale. Ndjenjat e besimit, privatësia, krenaria, miqësia, dashuria dhe humori janë të gjitha elemente të zhvillimit social – emocional të fëmijës”. (Alikaj, 2018)

Sipas Alikaj, “Është e rëndësishme të njihemi me ndryshimet dhe zhvillimin emocional të fëmijëve në mosha të ndryshme, kjo për të ndërtuar një urë komunikimi të shëndetshme me fëmijën. Në fëmijërinë e hershme fëmijët zhvillojnë konceptin e vetes dhe e të tjerëve, është e rëndësishme që ju të njihni atë që fëmija ndjen dhe aftësitë e tij për t’i shprehur ato, kështu do të mund të shmangni “grykimet” që mund të bëhen padashur ndaj sjelljeve apo emocioneve të caktuara të tyre. Duke njohur aftësitë emocionale dhe sociale të fëmijëve do të mundeni të shpërbleni dhe të nxisni sjelljet e duhura te ata, duke rritur kështu një fëmijë bashkëpunues, të qëndrueshëm dhe shumë social” (Alikaj, 2018).

“Zhvillimi social dhe emocional te fëmija luan rol të rëndësishëm në funksionimin e tashëm dhe të ardhshëm social të individit. Gjatë zhvillimit të fëmijës etapat e zhvillimit socio-emocionale, më vështirë identifikohen në krahasim me etapat e zhvillimit fizik dhe motorik. Shenjat e etapave të caktuara të zhvillimit vërehen më vështirë dhe nuk janë qartë të përkufizuara siç vërehen dhe përkufizohen në sferën e shëndetit fizik dhe zhvillimit motorik”. (Lena Damovska, 2008, f. 27)

2.3 Gjithëpërfshirja sociale e nxënësve

Gjatë procesit jetësor rol themelor në zhvillimin e individit luan edhe mjedisi ku ai jeton. Secili nga ne është i rrethuar nga anëtarët e familjes dhe të komunitetit ku jetojmë. Fëmija socializimin e fillon qysh në moshë të hershme kur fillon dhe njih anëtarët e afërt, ata që kujdesen për të. Pas ca kohe shumica e fëmijëve fillojnë kopshtin, aty njoftohen me shumë fëmijë të tjerë ku krijojnë raport njohje me njëri-tjetrin dhe fillojnë socializimin.

Për të pasur një zhvillim adekuat social dhe emocional është e rëndësishme të bëhet përfshirja sociale e nxënësve pa dallime.

“Përfshirja sociale është produkt si dhe proces i përmirësimit të kushteve për tu mundësuar grupeve dhe individëve pjesëmarrje në shoqëri. Është proces që ka për synim luftimin e diskriminimit, minimizimin e pabarazive shoqërore, shmangien e përjashtimit dhe marginalizimit si dhe sigurimin e mirëqenies për të gjithë anëtarët e një shoqërie, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, kulturore ose fetare.” (Ulrike Wol -Jontofsohn, 2015)

Sipas (Ulrike Wol -Jontofsohn, 2015) në udhëzues për mësimdhënës, “Kur individët ose grupet janë të integruara në shoqëri, ata/ato gëzojnë nivelet themelore të mirëqenies, qasje të plotë dhe të drejtë në burime dhe aktivitete kolektive, kanë të drejtë në pjesëmarrje aktive sociale si dhe të kenë mundësi të barabarta. Gjithashtu si kapitull i veçantë shpjegohen edhe treguesit e gjithëpërfshirjes sociale”.

“Treguesit për gjithëpërfshirjen sociale:

- ✓ Nivelet themelore të mirëqenies,
- ✓ Qasja e plotë në burime dhe aktivitete,
- ✓ Pjesëmarrja sociale,
- ✓ Mundësitë e barabarta,
- ✓ Pranimi dhe njohja” (Udhëzime për mësimdhënësit për gjithëpërfshirjen sociale të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në shkolla, 2015)

Nga perspektiva e arsimit, përfshirja sociale është proces i vet-realizimit të individëve të rinj përbrenda një shoqërie, pranimi dhe njohjes së potencialit të tij ose saj nga institucionet shoqërore, përmes qasjes në arsim dhe integritit në rrjetin e marrëdhënieve shoqërore në komunitet. Fëmijëria dhe rinia janë faza të jetës kur personat e rinj kalojnë nëpër tranzicionin

prej varësisë familjare kah autonomia përbrenda shoqërisë së gjerë nën rrethana që evoluojnë me shpejtësi të madhe. Kjo ka një kuptim të veçantë për ata persona të rinj me prejardhje të pa favorizuar dhe që jetojnë në kushte të pasigurta. Për ta përfshirja sociale do të thotë tejkalimi i pengesave të shumta në mënyrë që të kërkojnë të drejtat e tyre shoqërore si anëtarë të plotë të shoqërisë.

Në rastet kur bëhet përjashtimi i nxënësve nga gjithpërfshirja sociale, paraqiten efekte negative tek nxënësit të cilat më pas do të pasqyrohen në vetëbesim të ulët gjë që ndikon që edhe arritje të ulëta, mungesë të motivimit, shkëputje, tërheqje nga aktivitetet e klasës/shkollës, vijim jo të rregullt, refuzimi për të vijuar shkollën dhe në fund braktisje të shkollës. Në rastet e tilla nxënësit edhe pse janë të pranishëm brenda klasës e ndjejnë vetën të izoluar nga të tjerët. Kjo ndodh sepse ata e ndjejnë vetën të ndryshëm nga të tjerët për arsyeje të kushteve ekonomike, shkollimit të prindërve të tyre duke e etiketuar vetën si jo të zgjuar që nuk i përket “Elitës” së nxënësve të pasur dhe që kanë prindërit e shkolluar. Është profili i mësuesit ai i cili bënë që brenda klasës së tij të mos ekzistojnë këto ndarje dhe paragjykime por që të gjithë nxënësit të jenë të barabartë dhe të kenë mundësi të zhvillimit social në mënyre adekuate.

“Edukimi multikulturor paraqet një mjet për shfrytëzimin pozitiv të dallimeve kulturore në procesin e përgjithshëm arsimor. Në këtë proces, klasat dhe shkollat bëhen modele të demokracisë dhe barazisë mes njerëzve në shoqëri” (Bajrami D., Shabani A., 2019, f. 262).

Profili i mësuesit gjithpërfshirës sipas (Albana Markja, Dr. Marina Ndrio, Prof. Dr. Edmond Dragoti, Prof. Asoc. Irida Agolli, 2015) në librin “Edukimi dhe formimi i mësuesve për gjithpërfshirjen” u bazua në parime dhe parakushte të cilat mësuesit duhet të përvetësonin e që parimi kryesor dhe i pari ishte gjithpërfshirja si një qasje parimore, e bazuar tek e drejta për arsim në themel të së cilës qëndrojnë një sërë vlerash themelore. Nisur nga kjo shkollat gjithpërfshirëse janë ato vende ku hiqen “barrierat arsimore” dhe nxënësit e të gjitha aftësive arsimohen në klasat e arsimit të përgjithshëm.

“Mësuesit japin udhëzime të qarta për përfshirjen sociale, modelojnë sjellje shoqërore gjithpërfshirëse, ofrojnë mundësi shoqërore gjithpërfshirëse për studentët dhe presin që të gjithë studentët t’i përmbahen një sistemi besimi gjithpërfshirës.” (Eredics, 2018)

Nicole Eredics në librin e saj, jep shembullin cilat janë 10 gjërat të cilat bëjnë një klasë që të ketë gjithpërfshirjen sociale brenda saj:

1. Ndryshoni planin e ndenjësive - jepini studentëve një ndryshim të peizazhit dhe dikujt të ri për të punuar duke ndryshuar planin tuaj të ndenjësive disa herë gjatë vitit shkollor.

2. Gjeni gjuhën e përbashkët - lojërat e klasës, të tilla si "Gjeni dikë që", u jep studentëve një shans për të njohur njëri-tjetrin në një mënyrë argëtuese dhe joformale.

3. Punë me partnerë ose në grupe të vogla — vendosini studentët në partnerë dhe grupe të vogla për të përfunduar punën. Dhënia paraprakisht e udhëzimeve dhe pritshmërisë të studentëve për sjelljen në grup mund t'i ndihmojë studentët të përgatiten për një përvojë pozitive.

4. Ofroni aktivitete të strukturuar pushimi — koha e pa strukturuar e pushimit mund të jetë shumë e vështirë për disa studentë. Mund të jetë i vetmuar, i sikletshëm apo edhe kaotik. Ofroni disa lojëra të strukturuar dhe të mbikëqyrura që janë të hapura për të gjithë studentët.

5. Përdorni gjuhë përfshirëse shoqërore - gjuha gjithëpërfshirëse shoqërore është thelbësore për krijimin e një atmosfere respekti. Shkollat duhet të presin që nxënësit dhe stafi të përdorin fjalë të përshtatshme dhe të përgjegjshme nga ana kulturore.

6. Situatat e lojës me role ku nxënësit mund të përfshijnë njëri-tjetrin — luajtja e roleve në situata të zakonshme sociale mund t'u japë studentëve aftësitë që u nevojiten për të ndërvepruar me sukses me njëri-tjetrin.

7. Vendosni pritshmëri për sjellje shoqërore gjithëpërfshirëse — komunikoni qartë pritshmërinë tuaj për sjellje shoqërore gjithëpërfshirëse. Sigurohuni që të gjithë studentët të kuptojnë pritshmërinë.

8. Gjeni mënyra për të nxjerrë në pah interesat dhe pikat e forta të nxënësve — inkurajoni studentët të ndajnë gjërat e tyre të preferuara, të festojnë suksesin e studentëve në fusha të ndryshme të kurrikulës dhe të demonstrojnë talentin dhe/ose ekspertizën e tyre (një vit kisha një studente që i solli gajde në shkollë dhe ajo na luajti disa këngë).

9. Sigurohuni që të gjithë studentët të kenë një mënyrë efektive dhe të përshtatshme për të komunikuar-sigurohuni që pajisjet ndihmëse të punojnë siç duhet dhe të jenë të përgatitura që studentët të komunikojnë në mënyrë efektive me grupin e tyre të moshatarëve.

10. Ofroni mundësi/vende që studentët të takohen dhe të ndërveprojnë në klasën tuaj - krijoni hapësira ku studentët mund të punojnë së bashku, të lexojnë së bashku, të kenë diskutime, të kryejnë një aktivitet ose thjesht të shoqërohen me njëri-tjetrin. Përdorni lloje të ndryshme të ndenjësive, tavolinave dhe materialeve për të krijuar hapësira mikpritëse.

2.4 Mësimi social – emocional

Gjatë viteve të fundit, aftësitë sociale dhe emocionale janë rritur në agjendën e politikave arsimore dhe në debatin publik, sipas OECD. Krijuesit e politikave dhe praktikuesit e arsimit po kërkojnë mënyra për të plotësuar fokusin në mësimin akademik, me vëmendje ndaj zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale.

“Aftësitë shoqërore dhe emocionale janë një nëngrup i aftësive, attributeve dhe karakteristikave të një individi të rëndësishëm për suksesin individual dhe funksionimin shoqëror. Së bashku, ato përfshijnë një grup të plotë aftësish thelbësore që studentët të jenë në gjendje të kenë sukses në shkollë, në punë dhe të marrin pjesë plotësisht në shoqëri si qytetarë aktivë. Përfitimet e zhvillimit të aftësive social-emocionale të fëmijëve shkojnë përtej zhvillimit njohës dhe rezultateve akademike; ato janë gjithashtu shtytës të rëndësishëm të shëndetit mendor dhe perspektivave të tregut të punës.” (OECD, 2021)

Mësimi social-emocional është procesi i zhvillimit të vetëdijes, vetëkontrollit dhe aftësive ndërpersonale që janë jetike për suksesin në shkollë, punë dhe jetë.

Njerëzit me aftësi të forta social-emocionale janë më të aftë të përballojnë sfidat e përditshme dhe të përfitojnë nga ana akademike, profesionale dhe shoqërore. Nga zgjidhja efektive e problemeve tek vetëdisiplina, nga kontrolli i impulsit tek menaxhimi i emocioneve dhe më shumë, SEL siguron një bazë për efekte pozitive, afatgjata tek fëmijët, të rriturit dhe komunitetet. (Committee for children, 2017)

Për mësimin social ekzistojnë teori por që me e rëndësishme është e Albert Bandurës, të cilës iu referohen shumë shkrimtarë si ata vendor ashtu edhe ata ndërkombëtar.

“Teoria e të mësuarit social, e përfaqësuar nga A. Bandura është një degëzim i modelit biheaviorist dhe ndryshimet në sjellje individuale i lidh me dy shkaqe themelore: vëzhgimi dhe imitimi” (Përlala, 2008, f. 27)

Të mësuarit social dhe emocional i jep mundësi nxënësve të kuptojnë dhe menaxhojnë ndjenjat e tyre, të krijojnë empati etj. Kjo mënyrë e të mësuarit u jep nxënësve mundësinë të krijojnë lidhje të shëndetshme dhe raporte të mira me njerëzit, të marrin vendime të sigurta.

MentalUp 2019, thotë se “Mësimi social emocional (SEL) është një proces i rëndësishëm veçanërisht për fëmijët sepse mund të ndihmojë në rritjen e suksesit të fëmijëve. Mësimi social emocional thuhet se rrit suksesin mesatarisht me 11 pikë. Kjo është për shkak të zhvillimit të sjelljeve prosociale siç janë mirësia, ndarja dhe ndjeshmëria” (MentalUp, 2021).

Sipas web faqes Mental UP, mësimi social emocional gjithashtu përmirëson qëndrimet e nxënësve ndaj shkollës dhe zvogëlon depresionin dhe stresin tek nxënësit. Një program efektiv i të mësuarit emocional shoqëror përfshin një klasë të koordinuar, shkollë, familje dhe praktika të komunitetit që ndihmojnë studentët të zhvillojnë pesë aftësitë kryesore të mëposhtme:

1- Vetëdija: Aftësia për të perceptuar ndjenjat, mendimet e veta dhe për të njohur me saktësi se si ato ndikojnë në vlerat dhe sjelljen e tyre.

2- Vetë-menaxhimi: Aftësia për të organizuar me sukses emocionet, mendimet dhe sjelljet. Për shembull, aftësia për të vendosur qëllime personale dhe akademike dhe për të punuar drejt tyre.

3- Vetëdija sociale: Aftësia për të kuptuar, marrë dhe empatizuar me perspektivat e të tjerëve, përfshirë ato me kultura të ndryshme dhe mjedise kultivimi.

4- Aftësitë e marrëdhënieve: Aftësia për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie reciprokisht të shëndetshme dhe shpërblyese me individë dhe grupe të ndryshme.

5- Marrja e vendimeve me përgjegjësi: Të jetë në gjendje të bëjë zgjedhje konstruktive në lidhje me sjelljet etike, vendimet në lidhje me shqetësimet e sigurisë, sjelljen personale të bazuar në normat shoqërore dhe ndërveprimet shoqërore.

Këto pesë aftësi bëjnë që nxënësit të përjetojnë zhvillim përmes mësimi social – emocional.

2.5 Vështirësitë në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale tek nxënësit

Shkolla ka rol të rëndësishëm në nxitjen e të nxënësve dhe zhvillimin social - emocional. Në rastet kur nxënësit kanë përkrahje dhe bashkëpunim me të gjithë anëtarët e shkollës dhe të rrethit shoqëror, niveli i arritjeve të tyre është i lartë në të gjitha aspektet jo vetëm atë shkollor por edhe më pas gjatë jetës së tyre të përditshme, në krahasim me nxënësit të cilët nuk kanë raporte të mira me mësimdhënësit dhe nxënësit e tjerë.

Raportet e dobëta dhe marrëdhëniet negative me rrethin që e rrethojnë bënë që tek nxënësit të paraqiten vështirësi në zhvillimin e aftësive tek nxënësit. Vështirësitë e tilla nxënësit i reflektojnë edhe në jetën e përditshme si: vështirësitë të menaxhimit të emocioneve, vështirësi në ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve me bashkëmoshatarët, shfaqjen e zemërimit dhe kërcënimit, agresionit verbal dhe fizik.

Duke u rritur me moshë nxënësit, ngritën edhe nivelet e agresionit të cilat vazhdojnë gjithnjë e në rritje dhe në qoftë se nuk ndërpriten përfundojnë me dukuri si: vjedhje, dredhi ndaj të tjerëve, vandalizmi dhe abuzim të drogës.

Komunikimi i mirëfilltë me të gjithë u krijon nxënësve hapësirë që të kenë progres në zhvillimin e aftësive të tyre andaj prindërit, të rriturit dhe kujdestarët në jetën e tyre duhet të qëndrojnë në harmoni me nevojat specifike të fëmijës së tyre dhe të ndihmojnë në formimin e një kuadri të fortë për shëndetin social-emocional.

“Tre faktorë të rëndësishëm për përshtatjen psikosociale të nxënësve në shkollë dhe në jetën e mëvonshme janë marrëdhëniet shoqërore të nxënësve me mësuesit dhe bashkëmoshatarët dhe vetëbesimi i lartë. Në mënyrë të veçantë, marrëdhëniet pozitive student-mësues shoqërohen me rezultate pozitive të studentëve, të tilla si zhvillimi i aftësive shoqërore dhe marrëdhënie negative student-mësues me rezultate të padëshirueshme, të tilla si sjellja përçarëse e studentëve.” (Inge Zweers, 2020)

Marrëdhëniet pozitive me shokët ofrojnë një burim të rëndësishëm të mbështetjes sociale dhe një kontekst në të cilin nxënësit mësojnë të menaxhojnë marrëdhëniet shoqërore. Marrëdhëniet negative me kolegët i vënë nxënësit në rrezik për zhvillimin e problemeve akademike dhe vështirësive psikologjike të cilat në qoftë se rriten bënë që nxënësit të tërhiqen në vete dhe të ndodh të pësojnë depresion.

Nxënësit të cilët kanë vështirësi në zhvillimin e aftësive sociale - emocionale, një nga format më të parapëlqyera dhe që tregojnë rezultate në mënyrë pozitive në jetën e secilit fëmijë dhe që ndikon pozitivisht në zhvillimin e tyre është puna në grupe.

“Forma e punës në grupe ka determinantë sociologjike, psikologjike dhe didaktike. Njeriu është qenie grupocentrike, grupi e ka krijuar, në grup jeton dhe vetëm në grup dhe me

ndihmën e grupit social mund të fitoj tiparet e qenies njerëzore dhe të afirmohet si njeri” (Brada, 2010, f. 383)

Puna në grupe është shumë efektive për nxënësit. Nxënësit të cilët kanë mundësi të jenë pjesë e punës në grupe zhvillojnë shkathhtësi të mira në raport me të tjerët. Puna në grupe u ndihmon atyre në zhvillimin komunikativ, të të menduarit, zhvillon procesin kognjitiv, të njohjes, socializimit, bashkëpunimit, të shprehin emocionet më lirshëm duke tejkaluar kështu vështirësitë në zhvillimin e tyre dhe duke i lejuar hapësirë që të zhvillojnë aftësi udhëheqëse.

“Kur qëllimi i të nxënësve në grupe bashkëmoharësh është rritja e aftësive shoqërore ose rritja e shkallës së mirëkuptimit ndër grupor dhe vlerësimi i deversitetit, caktimi i roleve dhe i funksioneve specifike brenda grupit mbështet komunikimin. Në këtë situatë do të ishte e dobishme që rolet udhëheqëse të ndërrohen në mënyrë që grupet me përbërje të ndryshme të kenë mundësi të demonstrojnë dhe të zhvillojnë aftësi udhëheqëse” (Musai, 2014)

Brenda formimit të grupeve ekzistojnë edhe paragjykimet që kanë nxënësit për njëri – tjetrin, duke bërë që të kenë pastaj vështirësi në bashkëpunim dhe zhvillimin e aftësive që posedojnë.

“Paragjykimi është një qëndrim negativ i pajustificueshëm kundër një grupi dhe anëtareve të tij i bazuar në anëtarësinë e tyre në grup”. (Bërxulli, 2017)

Sipas (Andrijana Tasevska, 2017) në librin e saj thotë se fëmijët me vështirësi specifike në mësimnxënie janë në rrezik më të madh të zhvillojnë:

1. Pasqyrë negative për veten (se nuk janë mjaft të aftë, të mençur, të shkathhtë),
2. Motivimi i dobët për mësimnxënie,
3. Mosndihma e mësuar (që më parë, para se të tentojnë, mendojnë se nuk mundën, nuk dinë ...),
4. Anksioziteti (shqetësimi, sikleti, nuk ndjehet mirë),
5. Depresioni (jomotivim, i tërhjekur, i vetmuar).

2.6 Metodatat dhe teknikat për zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale tek nxënësit

Në klasat tona kemi nxënës të shtresave të ndryshme. Ata dallojnë sipas interesave, sipas stilit të jetesës, stilit të mësuarit andaj themi që jo gjithmonë puna e mësimit është e thjeshtë dhe e lehtë. Ne si mësues duhet munduar të gjejmë metodatat dhe teknikat më të mira të cilat nxënësit zhvillimin e aftësive sociale - emocionale tek nxënësit.

Parakushti themelor për zhvillim të suksesshëm social është zhvillimi emocional. Sipas (Florina Shehu S. P., 2014) “Fëmijët e moshës 3-6 vjeç bëhen gjithnjë më të interesuar për të bashkëpunuar me fëmijët e tjerë dhe për të krijuar miqësi. Pjesa më e madhe e tyre këtë e bëjnë me sukses, por disa janë shumë të turpshëm, agresivë ose e kanë vështirë t’i kontrollojnë emocionet e tyre dhe të kenë sjellje prosociale”.

Për këtë arsyeje libri i mësipërm përshkruan edhe strategjitë e mësimit në të cilat edukatori/ mësuesi duhet të mbështetet:

- “Edukatori i suksesshëm krijon atmosferë të komunitetit dhe i ndihmon fëmijës të ndjehet pjesë e asaj bashkësie. Duhet të krijohet atmosferë në të cilën nga fëmijët pritet të jenë të dashur ndaj njëri-tjetrit dhe të ndihmohen mes vete.
- Organizohen hapësirën ashtu që të ekzistojnë kënde të hapura për punë në grup të madh dhe kënde të mbyllura për punë në grup të vogël.
- Vendosni rutinë ditore, orar të aktiviteteve, që të gjithë fëmijët ta bëjnë punën e njëjtë secilën ditë. Lejojuni fëmijëve të kënaqen derisa luajnë bashkërisht, e jo të ndjejnë presion se detyra patjetër duhet të kryhet me kohë.
- Kushtojuni kujdes aktiviteteve që kanë qenë të përbashkëta, pa marrë parasysh se a janë aktivitete rutinore (mbledhja e lodrave “T’i mbledhin lodrat dhe t’i lëmë në vendin e tyre, që të mos presin deri nesër!”) ose aktivitete të veçanta (“Sa gjethe të bukura kemi mbledhur jashtë – çka të bëjmë me ato?”).
- Inicioni aktivitete që kërkojnë punë grupore. Kështu edhe ata fëmijë që më shumë dëshirojnë lojëra solo, do të ndjehen të sigurt në aktivitetet grupore, ku nuk do ta ndjejnë presionin e kompetencës. Kur aktivitetet janë të iniciuara nga fëmijët, ata kanë më shumë liri që të vendosin se sa të shoqërueshëm dëshirojnë të jenë. Gjatë kohës së

aktiviteteve në grup të vogël fëmijët më shumë diskutojnë ndërmjet vete dhe ndihmohen më shumë. Ndërkaq, gjatë aktiviteteve në grup të madh, ku – për shembull – këndojnë bashkërisht, ekziston më pak rrezik që fëmija i turpshëm të ndjehet i frikësuar – këto janë aktivitete me rrezik të ulët social.

➤ Inkuadroni fëmijët në aktivitete përreth çerdhes, në lagje, si për shembull të mbledhin gjethe, degë, gurë dhe gjithçka tjetër që mund të shërbejë si material pune, që të mbledhin sende të panevojshme nga oborri. Shkoni në shëtitje dhe diskutoni se si fqinjët i kanë rregulluar oborret e tyre, si i kanë ata dekoruar dritaret, si i kanë rregulluar shitësit vitrinat e tyre etj.

➤ Ndhimoheni bashkëpunimin ndërmjet fëmijëve dhe mos e kufizoni numrin e fëmijëve që dëshirojnë të luajnë një lojë të caktuar në kohë të njëjtë.

➤ Ndhimoheni fëmijëve agresivë ose më të tërhequr që të luajnë me moshatarët e tyre. Nëse fëmija përpiqet që me dhunë të imponohet në lojë, sugjeroni se si është më lehtë të inkuadrohet dhe të jetë i pranuar” (Florina Shehu S. P., 2014).

Sipas (Save The Children, 2017) janë disa metoda dhe teknika të cilat duhet përdorur për të zhvilluar aftësitë sociale dhe emocionale të nxënësve duke filluar nga më e thjeshta.

1. “Krijoni modele pozitive të sjelljes për fëmijët tuaj,
2. Ndhimoheni fëmijët që gradualisht të zhvillojnë vet-kontrollin,
3. Komunikoni haptas me ta,
4. Respektoni fëmijët për të fituar respektin e tyre,
5. Mësoni fëmijët si të marrin vendime të duhura,
6. Rritni vetëbesimin dhe aftësitë e fëmijëve,
7. Mësoni fëmijët t’i respektojnë ndjenjat e njerëzve tjerë” (Save The Children, 2017).

Shumë aftësi janë të rëndësishme në zhvillimin e marrëdhënieve të fëmijëve me të rriturit dhe moshatarët. “Aftësitë i ndihmojnë fëmijët të mësojnë vetë-rregullimin (aftësinë për t’iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme ankthit, shqetësimit ose ndjesive të pakëndshme) dhe si të zgjidhin problemin.” (Lise Fox, 2006, f. 3)

Në artikullin e lartpërmendur, modeli i piramidës mësimore inkurajon edukatorët e hershëm për t’i mësuar fëmijët këto aftësi në mënyrë sistematike, duke përdorur procedurat e

planifikuara brenda aktiviteteve të përshtatshme për zhvillim dhe me intensitet të mjaftueshëm për sigurohuni që fëmijët t'i mësojnë aftësitë shpejt dhe mund t'i përdorin ato kur është e nevojshme.

Ndjekja e rregullave, rutinave, dhe drejtimet, identifikimi i ndjenjave në veten dhe të tjerët, kontrollimi i zemërimit dhe impulse, zgjidhja e problemeve, sugjerimi i temave të lojërave dhe aktivitete për bashkëmoshatarët, ndarja e lodrave dhe të tjerë material, ndihma për të rriturit dhe bashkëmoshatarët, të kuptuarit se si dhe kur të kërkosh falje, shprehja e empatisë me ndjenjat e të tjerëve e shumë të tjera janë aftësi të cilat duhet përvetësuar nga fëmijët gjatë zhvillimit të tyre.

Në artikullin metodologjik (Neal, 2020) thotë se mësimdhënësit mund të përqendrohen në teknikat e mbledhjes së të dhënave (p.sh. matja vëzhguese e ndërveprimeve sociale në klasa), matja (p.sh. zhvillimi i shkallëve të reja për të matur aspektet e zhvillimit emocional) ose çështje analitike (p.sh. rrjetet sociale për të ekzaminuar bashkëmoshatarët marrëdhëniet), për arsyeje të zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve.

Për këto arsyeje themi që zhvillimi i aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve është tejet e rëndësishme në funksion të përgatitjes së nxënësve për jetën pasi mësimet nuk merren vetëm në shkollë por gjatë gjithë jetës së tyre.

Kreu III

3.0 Metodologjia e hulumtimit

Për t'u përgatitur ky punim do të përdoren këto metoda:

1. Metoda teorike,
2. Metoda komparative (krahasuese),
3. Metoda deskriptive (përshkruese),
4. Metoda analitike.

3.1 Objektivat e hulumtimit

- Identifikimi i vështirësive që paraqiten gjatë ndërtimit të personalitetit të nxënësve
- Analizimi i metodave dhe teknikave të cilat nxisin zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve
- Vlerësimi i aftësive të zhvilluara sociale - emocionale në funksion të përgatitjes së nxënësve për jetën

3.2 Hipoteza

Hipotezat kryesore të këtij punimi janë:

1. Hipoteza e përgjithshme (gjenerale)

Aftësitë sociale dhe emocionale, si dhe komunikimi social, të vendosura në kontekstin e një sjelljeje specifike të individëve dhe si një formë e natyrshme e jetës njerëzore, janë një mbështetje në përgatitjen e nxënësve për tregun e punë, karrierë të sukseshme dhe jetë më të dinjitetshme.

2. Hipoteza e veçantë

Mësimdhënësit e shkollave fillore përmes metodave efikase dhe ndërveprimeve shoqërore ofrojnë një zhvillim adekuat të aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve, me qëllim që ata të përshkatan kërkesave të industrisë dhe komunitetit.

3.3 Analizat e të dhënave, prezantimi i rezultateve dhe diskutimi

3.1.1 Rezultatet nga pyetësi

Hulumtimi është realizuar përmes pyetësorëve të standardizuar i cili është një instrument i përshtatshëm për grumbullimin e të dhënave dhe për të nxjerrë rezultate të përgjithshme.

Përpilimi i pyetësorëve


Pyetjet në pyetësor kanë qenë të përpiluara me llojin e tipit të mbyllur dhe u janë drejtuar mësimdhënësve të ciklit të ulët, të klasave të para deri në të pesta (I – V), në shkollat fillore të shtetit të Kosovës. Pyetësi përbëhet nga 15 pyetje të cilat synojnë të zbulojnë mënyrat e zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve, ndikimi i rrethit familjar, shoqëror, rolin e bashkëpunimit ndërmjet të gjithë akterëve në shkollë dhe arritjet e nxënësve në funksion për jetë.

Pyetjet personale për mësimdhënës

Gjinia:

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimdhënësve	Të dhënat në përqindje
• <i>Mashkull</i>	41	27.3%
• <i>Femër</i>	109	72.7%

Gjinia:
150 responses




Grafiku 1. Gjinia e mësimeve

Nga rezultatet e paraqitura në grafikun numër 1 vërejmë se prej 150 mësimeve, pjesa më e madhe e tyre janë femra gjithsej 109 femra apo 72.7% ndërsa meshkuj janë 41 apo 27.3% .

Mosha:

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimeve	Të dhënat në përqindje
• 18 – 25 vjeç	48	32%
• 26 – 35 vjeç	78	52%
• 36 – 50 vjeç	15	10%
• Mbi 50 vjeç	9	6%

Mosha:
150 responses




Grafiku 2. Mosha e mësimdhënësve

Nga rezultatet e paraqitura në grafikun numër 2 vërejmë se prej 150 mësimdhënësve, pjesa më e madhe e tyre janë të moshës 26 – 36 vjeç rreth 78 apo 52% e tyre, të moshës 18 – 25 vjeç janë 48 apo 32%, të moshës 36 – 50 janë gjithsej 15 apo 10% dhe të moshës mbi 50 vjeç janë 9 mësimdhënës apo 6% e të anketuarve.

Niveli arsimor:

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimdhënësve	Të dhënat në përqindje
• <i>Bachelor</i>	115	76.7%
• <i>Master</i>	35	23.3%

Niveli arsimor:
150 responses



Grafiku 3. Niveli arsimor


Nga rezultatet e paraqitura në grafikun numër 3 vërejmë se shumica e mësimeve kanë përfunduar vetëm nivelin bachelor rreth 115 apo 76.7% e tyre ndërsa vetëm 35 apo 23.3% e tyre kanë përfunduar nivelin master.

Vendi ku punoni:

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimeve	Të dhënat në përqindje
• <i>Urban</i>	59	39.3%
• <i>Rural</i>	91	60.7%

Vendi ku punoni:

150 responses



Grafiku 4. Vendi ku punojnë mësimdhënësit


Nga rezultatet e paraqitura në grafikun numër 4 vërejmë se pjesa më e madhe e mësimdhënësve punojnë në vendin rural rreth 91 mësimdhënës apo 60.7% kurse pjesa tjetër në vendin urban rreth 59 apo 39.3%.

Përvoja juaj në mësimdhënie:

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimdhënësve	Të dhënat në përqindje
• 1 – 5 vjet	118	78.7%
• 6 – 10 vjet	9	6%
• 11 – 15 vjet	7	4.7%
• Mbi 15 vjet	16	10.7%

Përvoja juaj e punës në mësimdhënie:

150 responses



Grafiku 5. Përvoja në mësimdhënie

Sipas grafikut të pestë vërejmë se shumica e mësimdhënësve kanë përvojë 1 – 5 vjet rreth 118 apo 78.7% e tyre, 6 -9 vjet gjithsej 9 apo 6% të mësimdhënësve, 11 – 15 vjet 7 apo 4.7% dhe mbi 15 vjet gjithsej 16 mësimdhënës apo 10.7%.


Përgjigjet e mësimitdhënësve drejtuar temës së hulumtuar

1. Gjatë shkollimit të juaj, njohuritë e marra për personalitetin, zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve janë në nivelin e duhur!

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimitdhënësve	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	61	40.7%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	72	48%
• <i>Neutral</i>	7	4.7%
• <i>Nuk pajtohem</i>	10	6.7%

1. Gjatë shkollimit të juaj, njohuritë e marra për personalitetin, zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve janë në nivelin e duhur!

150 responses



Grafiku 6. Niveli i njohurive të marra për personalitetin, zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve gjatë shkollimit të mësimitdhënësve.

Sipas grafikut të gjashtë, në pyetjen e parë: "Gjatë shkollimit të juaj, njohuritë e marra për personalitetin, zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve janë në nivelin e duhur!" pjesa më e madhe e mësimitdhënësve rreth 72 apo 48% janë përgjigjur *Pajtohem pjesërisht* duke lënë kështu të kuptohet që njohuritë e tyre nuk kanë qenë të nivelit të duhur. Rreth 61 apo 40.7% e mësimitdhënësve janë përgjigjur që *Pajtohen plotësisht*, rreth 10 apo 6.7 janë përgjigjur *Nuk pajtohem* dhe 7 apo 4.7 janë përgjigjur *Neutral*.


Nga ky grafik kuptojmë që mësimet për zhvillimin e personalitetit, zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale nuk janë të nivelit të duhur por që duhet kushtohet rëndësi edhe më e madhe këtyre temave gjatë shkollimit.

2. Formimi i personalitetit të shëndoshë të nxënësve është i lidhur ngushtë me zhvillimin social dhe emocional të tyre.

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimdhënësve	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	126	84%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	22	14.7%
• <i>Neutral</i>	2	1.3%
• <i>Nuk pajtohem</i>	0	0%

2. Formimi i personalitetit të shëndoshë të nxënësve është i lidhur ngushtë me zhvillimin social dhe emocional të tyre.

150 responses




Grafiku 7. Lidhja e zhvillimit social dhe emocional me formimin e personalitetit

Sipas grafikut numër 7, në pyetjen e dytë: “Formimi i personalitetit të shëndoshë të nxënësve është i lidhur ngushtë me zhvillimin social dhe emocional të tyre”, shumica e mësimdhënësve janë përgjigjur *Pajtohem plotësisht* rreth 126 apo 84%, *Pajtohem pjesërisht* 22 apo 14.7%, *Neutral* janë përgjigjur 2 mësimdhënës apo 1.3%, ndërsa *Nuk pajtohem* nuk është përgjigjur asnjë mësimdhënës.

3. *Hapat e parë të zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve merren në familje.*

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimdhënësve	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	131	87.3%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	18	12%
• <i>Neutral</i>	1	0.7%
• <i>Nuk pajtohem</i>	0	0%

3. Hapat e parë të zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve merren në familje.
150 responses



Grafiku 8. Marrja e hapave të parë në familje për zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve

Sipas grafikut numër 8, në pyetjen e tretë se: “ Hapat e parë të zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve merren në familje”, rreth 131 apo 87.3% e mësimdhënësve janë përgjigjur *Pajtohem plotësisht*, 18 apo 12% janë përgjigjur *Pajtohem pjesërisht*, ndërsa 1 mësimdhënës apo 0.7% është përgjigjur *Neutral*. Sipas grafikut kuptojmë që në alternativën *Nuk pajtohem* nuk është përgjigjur asnjë mësimdhënës.


Bazuar edhe në literaturën e hulumtuar, hapat e parë të zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve merren në familje pikërisht në rrethin e ngushtë familjarë duke u mbështetur nga gjyshërit, nëna, babai dhe pjesa tjetër e familjes.

4. Zhvillimi i aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve varet nga faktorë të ndryshëm si gjenetika, rrethi familjar, rrethi shoqëror, kultura, edukimi.

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimdhënësve	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	129	86%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	19	12.7%
• <i>Neutral</i>	2	1.3%
• <i>Nuk pajtohem</i>	0	0%

4. Zhvillimi i aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve varet nga faktorë të ndryshëm si gjenetika, rrethi familjar, rrethi shoqëror, kultura, edukimi.

150 responses



Grafiku 9. Ndikimi i faktorëve të ndryshëm në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve

Sipas grafikut numër 9, në pyetjen e katërt: “Zhvillimi i aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve varet nga faktorë të ndryshëm si gjenetika, rrethi familjar, rrethi shoqëror, kultura, edukimi”, 129 apo 86% e mësimdhënësve janë përgjigjur *Pajtohem plotësisht*, 19 apo 12,7% janë përgjigjur *Pajtohem pjesërisht*, dhe 2 mësimdhënës apo 1.3% janë përgjigjur *Neutral*. Në alternativën *Nuk pajtohem* nuk është përgjigjur asnjë mësimdhënës.


Nga të dhënat e mbledhura kuptojmë që pjesa më e madhe e mësimdhënësve që janë pajtuar plotësisht e kuptojnë rëndësinë e ndikimit të faktorëve të ndryshëm në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale tek nxënësit.

5. *Zhvillimi i aftësive sociale – emocionale të nxënësve në shkollë varet nga metodat që përdorin mësuesit/et për zhvillimin e tyre*

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimeve	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	66	44%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	73	48.7%
• <i>Neutral</i>	8	5.3%
• <i>Nuk pajtohem</i>	3	2%

5. Zhvillimi i aftësive sociale – emocionale të nxënësve në shkollë varet nga metodat që përdorin mësuesit/et për zhvillimin e tyre.

150 responses



Grafiku 10. Varja e zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve nga metodat që përdorin mësuesit/et.


Në grafikun numër 10, në pyetjen e pestë: “Zhvillimi i aftësive sociale – emocionale të nxënësve në shkollë varet nga metodat që përdorin mësuesit/et për zhvillimin e tyre”, shumica e mësimeve janë përgjigjur në alternativën *Pajtohem pjesërisht* rreth 73 apo 48.7%, në alternativën *Pajtohem plotësisht* rreth 66 apo 44%, *Neutral* janë përgjigjur 8 apo 5.3% të mësimeve dhe *Nuk pajtohem* 3 mësimeve apo 2%. Mësimeve mendojnë që zhvillimi i aftësive të nxënësve nuk varet nga përdorimi i strategjive që përdorin ata, por duke u bazuar nga përvojat personale si mësimeve mendojnë që është e gabuar. Duke përdorur strategji në mënyrë zhvillimin e aftësive sociale – emocionale tek nxënësit.

6. *Për të zhvilluar aftësitë sociale – emocionale është e rëndësishme të përdorim strategji të duhura sepse çdo nxënës është unik.*

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimdhënësve	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	134	89.3%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	13	8.7%
• <i>Neutral</i>	2	1.3%
• <i>Nuk pajtohem</i>	1	0.7%

6. Për të zhvilluar aftësitë sociale – emocionale është e rëndësishme të përdorim strategji të duhura sepse çdo nxënës është unik.

150 responses



Grafiku 11. Përdorimi i strategjive të duhura për zhvillimin e aftësive sociale – emocionale

Në grafikun e 11, në pyetjen e gjashtë vërejmë që në pyetjen: “Për të zhvilluar aftësitë sociale – emocionale është e rëndësishme të përdorim strategji të duhura sepse çdo nxënës është unik”, në alternativën e parë *Pajtohem plotësisht* janë përgjigjur shumica e mësimdhënësve 134 apo 89.3% e tyre, në alternativën *Pajtohem pjesërisht* janë përgjigjur 13 apo 8.7%, në alternativën *Neutral* janë përgjigjur 2 apo 1.3%, ndërsa *Nuk pajtohem* është përgjigjur 1 mësimdhënës apo 0.7%.

Nga përgjigjet kuptojmë që pjesa më e madhe e tyre pajtohen plotësisht dhe përdorin strategji të ndryshme për zhvillimin e aftësive të nxënësve duke u bazuar në zhvillimin e personalitetit të nxënësve. Por nuk është e thënë se në qoftë se një strategji e përdorur me një nxënës bënë që nxënësi të ketë sukses të mendojmë që e njëjta strategji do të funksionoj edhe me


nxënësit e tjerë dhe ata kanë sukses sepse duhet përdorur strategji të duhura me çdo nxënës sepse ai është unik.

7. Format më të parapëlqyera për zhvillimin e aftësive sociale – emocionale janë puna në dyshe dhe në grupe

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mesimdhënësve	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	68	45.3%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	59	39.3%
• <i>Neutral</i>	20	13.3%
• <i>Nuk pajtohem</i>	3	2%

7. Format më të parapëlqyera për zhvillimin e aftësive sociale – emocionale janë puna në dyshe dhe në grupe.

150 responses



Grafiku 12. Format më të parapëlqyera për zhvillimin e aftësive sociale – emocionale

Në grafikun numër 12, në pyetjen e shtatë: “Format më të parapëlqyera për zhvillimin e aftësive sociale – emocionale janë puna në dyshe dhe në grupe”, mesimdhënësit janë përgjigjur në mënyra të ndryshme por që alternativa e parë ka përqindjen më të madhe. *Pajtohem plotësisht* janë përgjigjur 68 apo 45.3% e mesimdhënësve, *Pajtohem pjesërisht* janë përgjigjur 59 apo 39.3%, *Neutral* janë përgjigjur 20 apo 13.3% dhe në alternativën *Nuk pajtohem* janë përgjigjur 3 apo 2% e mesimdhënësve.


Puna në dyshe dhe në grupe cilësohen si format më të përshtatshme për zhvillimin e aftësive të nxënësve. Mungesa e shkollimit të duhur ka bërë që mësimit të përgjigjen në forma të ndryshme duke mos e kuptuar rëndësinë e vërtetë të këtyre formave.

8. Nxënësit me aftësi të pazhvilluara sociale - emocionale kanë vështirësi të krijojnë shokë të rinj dhe të integrohen në shoqëri

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimit të duhur	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	81	54%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	55	36.7%
• <i>Neutral</i>	10	6.7%
• <i>Nuk pajtohem</i>	4	2.7%

8. Nxënësit me aftësi të pazhvilluara sociale - emocionale kanë vështirësi të krijojnë shokë të rinj dhe të integrohen në shoqëri.

150 responses



Grafiku 13. Vështirësitë e nxënësve me aftësi të pazhvilluara sociale – emocionale

Në grafikun numër 13, në pyetjen e tetë: “Nxënësit me aftësi të pazhvilluara sociale - emocionale kanë vështirësi të krijojnë shokë të rinj dhe të integrohen në shoqëri”, mësimit janë përgjigjur në alternativën e parë *Pajtohem plotësisht* 81 apo 54%, në alternativën e dytë *Pajtohem pjesërisht* janë përgjigjur 55 apo 36.7% e mësimit të duhur,

alternativen e tretë *Neutral* janë përgjigjur 10 mësimdhënës apo 6.7% dhe në alternativën e fundit *Nuk pajtohem* janë përgjigjur 4 mësimdhënës apo 2.7%.


Sipas literaturave të ndryshme, nxënësit me aftësi të pazhvilluara e kanë të vështirë të krijojnë shokë të rinj dhe integrohen në shoqëri si pasojë e mos dijes së qasjes së tyre në shoqëri dhe për këtë arsyeje ndjehen të vetmuar dhe të pasigurt në krijimin e shokëve të rinj.

9. Zhvillimi i mirëfilltë i aftësive sociale – emocionale e ndihmojnë nxënësin të përgatitet edhe për jetën jashtë shkollore.

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimdhënësve	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	125	83.3%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	19	12.7%
• <i>Neutral</i>	5	3.3%
• <i>Nuk pajtohem</i>	1	0.7%

9. Zhvillimi i mirëfillt i aftësive sociale – emocionale e ndihmojnë nxënësin të përgatitet edhe për jetën jashtë shkollore.

150 responses



Grafiku 14. Zhvillimi i aftësive sociale – emocionale dhe ndikimi që nxënësit të përgatiten për jetë

Në grafikun numër 14, në pyetjen e nëntë: “Zhvillimi i mirëfilltë i aftësive sociale – emocionale e ndihmojnë nxënësin të përgatitet edhe për jetën jashtë shkollore”, janë përgjigjur


125 apo 83.3% në alternativën *Pajtohem plotësisht*, 19 apo 12.7% janë përgjigjur *Pajtohem pjesërisht*, 5 mësimdhënës apo 3.3% janë përgjigjur *Neutral* dhe 1 mësimdhënës apo 0.7% është përgjigjur *Nuk pajtohem*.

Mësimet e marra në shkollë si mësimet jete bëjnë që nxënësit të kenë progres edhe në jetën jashtë shkollore. Zhvillim të duhur social – emocional bënë që tek nxënësit të mos paraqiten vështirësi në jetën pas shkollore, të integrohen në tregun e punës dhe të kenë suksese në jetën e tyre.

10. Të mësuarit përmes lojës nxit zhvillimin e aftësive tek nxënësit.

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimdhënësve	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	134	89.3%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	15	10%
• <i>Neutral</i>	1	0.7%
• <i>Nuk pajtohem</i>	0	0%

10. Të mësuarit përmes lojës nxit zhvillimin e aftësive tek nxënësit.
150 responses



Grafiku 15. Nxitja e zhvillimit të aftësive përmes lojës

Në grafikun numër 15, në pyetjen e dhjetë: “Të mësuarit përmes lojës nxit zhvillimin e aftësive tek nxënësit”, më shumë se gjysma e mësimdhënësve janë përgjigjur *Pajtohem plotësisht* rreth 134 apo 89.3%, në alternativën *Pajtohem pjesërisht* janë përgjigjur 15

mësimdhënës apo 10% dhe në alternativën *Neutral* është përgjigjur 1 mësimdhënës 0.7%. Në alternativën e fundit *Nuk pajtohem* nuk është përgjigjur asnjë mësimdhënës.


Loja është pjesa më e rëndësishme e fëmijëve andaj edhe mësimet përmes lojës bëhen atraktive dhe më të dashura nga ana e tyre. Loja i ndihmon nxënësit që të zhvillohen në mënyrën sociale dhe emocionale duke ndihmuar kështu që nxënësit të pranojnë më lehtë njëri – tjetrin si pjesë e shoqërisë dhe bashkësisë ku shkollohen. Për këto arsyeje në ditët e sotme shumica e mësimdhënësve e bazojnë mësimin e tyre në lojë duke ju mundësuar një zhvillim të duhur social – emocional nxënësve. Kjo vërehet edhe në përgjigjet e tyre të dhëna në pyetjen më lart.

11. Fëmijët zhvillojnë aftësi pozitive sociale – emocionale në bashkëveprim me moshatarët dhe të rriturit.

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimdhënësve	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	102	68%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	41	27.3%
• <i>Neutral</i>	6	4%
• <i>Nuk pajtohem</i>	1	0.7%

11. Fëmijët zhvillojnë aftësi pozitive sociale – emocionale në bashkëveprim me moshatarët dhe të rriturit.

150 responses



Grafiku 16. Zhvillimi i aftësive pozitive në bashkëveprim me moshatarët dhe të rriturit

Në grafikun numër 15, vërejmë se në pyetjen: “Fëmijët zhvillojnë aftësi pozitive sociale – emocionale në bashkëveprim me moshatarët dhe të rriturit”, më shumë se gjysma e mësimdhënësve janë përgjigjur *Pajtohem plotësisht* rreth 102 apo 68%, në alternativën *Pajtohem pjesërisht* janë përgjigjur 41 mësimdhënës apo 27.3%, në alternativën *Neutral* janë përgjigjur 6 mësimdhënës apo 4% dhe në alternativën e fundit *Nuk pajtohem* është përgjigjur 1 mësimdhënës apo 0.7%.


Themelet e para të marra në shtëpi janë ato që e vendosin përfundimisht se si do të vazhdoj nxënësi gjatë tërë jetës. Për këtë arsyeje nxënësit në saje të përvojave të mira në familje arrijnë edhe në shkollë që të krijojnë marrëdhënie pozitive me moshatarët dhe të rriturit e tjerë.

12. Gjatë procesit të socializimit dhe bashkëpunimit fëmijët ndjehen pjesë e shoqërisë.

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimdhënësve	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	122	81.3%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	27	18%
• <i>Neutral</i>	1	0.7%
• <i>Nuk pajtohem</i>	0	0%

12. Gjatë procesit të socializimit dhe bashkëpunimit fëmijët ndjehen pjesë e shoqërisë.

150 responses



Grafiku 17. Procesi i socializimit dhe bashkëpunimit të fëmijëve

Në grafikun numër 17, vërejmë se në pyetjen: “Gjatë procesit të socializimit dhe bashkëpunimit fëmijët ndjehen pjesë e shoqërisë”, rreth 122 apo 81.3% e mësimdhënësve janë përgjigjur *Pajtohem plotësisht*, në alternativën *Pajtohem pjesërisht* janë përgjigjur 27 mësimdhënës apo 18% dhe në alternativën *Neutral* është përgjigjur 1 mësimdhënës 0.7%. Në alternativën e fundit *Nuk pajtohem* nuk është përgjigjur asnjë mësimdhënës.


Nga mbledhja e të dhënave kuptojmë që pjesa më e madhe e mësimdhënësve e kanë kuptuar rëndësinë e procesit të socializimit. Kjo vërehet jo vetëm në përgjigjet e tyre por edhe në punën që realizojnë ata me nxënësit e tyre. Fëmijët duke bashkëpunuar me shok apo shoqe ndjehen edhe pjesë e shoqërisë.

13. Gjithpërfshirja sociale ndikon në klimën pozitive brenda klasës dhe bënë që nxënësit të përjetojnë progres gjatë zhvillimit të tyre.

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimdhënësve	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	119	79.3%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	28	18.7%
• <i>Neutral</i>	3	2%
• <i>Nuk pajtohem</i>	0	0%

13. Gjithpërfshirja sociale ndikon në klimën pozitive brenda klasës dhe bënë që nxënësit të përjetojnë progres gjatë zhvillimit të tyre sidhe të pranohen nga të tjerët.

150 responses



Grafiku 18. Ndikimi i gjithpërfshirjes sociale në progresin e nxënësve

Në grafikun numër 18, vërejmë se në pyetjen: “Gjithpërfshirja sociale ndikon në klimën pozitive brenda klasës dhe bënë që nxënësit të përjetojnë progres gjatë zhvillimit të tyre”, janë përgjigjur 119 apo 79.3% në alternativën *Pajtohem plotësisht*, 28 apo 18.7% janë përgjigjur *Pajtohem pjesërisht* dhe 3 mësimdhënës apo 2% janë përgjigjur *Neutral*. Në alternativën e fundit *Nuk pajtohem* nuk është përgjigjur asnjë mësimdhënës.


Nga grafiku kuptojmë që shumica e mësimdhënësve në klasat e tyre përdorin gjithpërfshirjen sociale dhe krijojnë një ambient të përshtatshëm për të gjithë nxënësit. Nxënësit në saje të gjithpërfshirjes arrijnë që të përjetojnë suksese në vazhdimësi.

14. Gjatë punës me nxënës, drejtuar zhvillimit të aftësive të tyre ndihmoheni edhe nga pjesa tjetër e aktivitetit të shkollës (psikologu, pedagogu, mësuesi ndihmës).

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimdhënësve	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	78	52%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	42	28%
• <i>Neutral</i>	15	10%
• <i>Nuk pajtohem</i>	15	10%

14. Gjatë punës me nxënës, drejtuar zhvillimit të aftësive të tyre ndihmoheni edhe nga pjesa tjetër e aktivitetit të shkollës (psikologu, pedagogu, mësuesi ndihmës).

150 responses



Grafiku 19. Ndhimja e aktivitetit të shkollës drejtuar zhvillimit të aftësive të nxënësve

Në grafikun numër 19, vërejmë se në pyetjen: “Gjatë punës me nxënës, drejtuar zhvillimit të aftësive të tyre ndihmoheni edhe nga pjesa tjetër e aktivitetit të shkollës (psikologu, pedagogu, mësuesi ndihmës)”, në alternativën *Pajtohem plotësisht* janë përgjigjur rreth 78 apo 52%, në alternativën *Pajtohem pjesërisht* janë përgjigjur 42 mësime apo 28%, në alternativën *Neutral* janë përgjigjur 15 mësime apo 10% dhe gjithashtu edhe në alternativën e fundit *Nuk pajtohem* janë përgjigjur 15 mësime apo 10%.


Nga përgjigjet kuptojmë që mësimeve në disa shkolla nuk ndihmohen nga pjesa tjetër e shkollës. Punën e realizojnë vetëm ashtu siç mundën por pa ndihmën e psikologut, pedagogut apo mësuesit ndihmës.

15. Bashkëpunimi mësues - prindër është çelësi i suksesit për zhvillimin e aftësive sociale – emocionale dhe të arriturve të tjera të nxënësve!

Vlerat e madhësive të matura:	Përgjigjet e mësimeve	Të dhënat në përqindje
• <i>Pajtohem plotësisht</i>	131	87.3%
• <i>Pajtohem pjesërisht</i>	16	10.7%
• <i>Neutral</i>	3	2%
• <i>Nuk pajtohem</i>	0	0%

15. Bashkëpunimi mësues - prindër është çelësi i suksesit për zhvillimin e aftësive sociale – emocionale dhe të arriturave të tjera të nxënësve!

150 responses



Grafiku 20. Bashkëpunimi mësues – prindër si çelës sukcesi

Në grafikun numër 20, vërejmë se në pyetjen: “Bashkëpunimi mësues - prindër është çelësi i suksesit për zhvillimin e aftësive sociale – emocionale dhe të arriturave të tjera të nxënësve!”, janë përgjigjur 131 apo 87.3% në alternativën *Pajtohem plotësisht*, 16 apo 10.7% janë përgjigjur *Pajtohem pjesërisht* dhe 3 mësimdhënës apo 2% janë përgjigjur *Neutral*. Sipas grafikut kuptojmë që në alternativën e fundit *Nuk pajtohem* nuk është përgjigjur asnjë mësimdhënës.

Nga përgjigjet e mësimdhënësve vërehet rëndësia që ata i kushtojnë bashkëpunimit me prindër si çelës i suksesit të të arriturave të nxënësve.

3.2 Kufizimet

Përveç realizimit të suksesshëm të hulumtimit, ka pasur edhe disa kufizime. Ndonëse aftësitë sociale dhe emocionale janë një temë aktuale, mjaftë e gjerë dhe ka pasur mjaftë literaturë por që më së shumti në gjuhën angleze. Literatura jonë vendore është më e mangët për zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale në funksion të përgatitjes së nxënësve për jetën në krahasim me atë të huaj. Gjithashtu për metodat dhe strategjitë për zhvillimin e aftësive sociale - emocionale dhe mësimin social – emocional, si pasojë e mungesës së teksteve në gjuhën shqipe kam përdorur më shumë literaturën angleze por që më pas kam bërë përkthimin e tyre.

Kreu IV

4.0 Përfundimet dhe rekomandimet

4.1 Përfundime

Bazuar në literaturën e hulumtuar kuptojmë që fëmijët mësojnë vlerat morale dhe konventat shoqërore përmes një procesi të socializmit, shumica e të cilave përfshinë prindërimin. Prosesi është i dyanshëm dhe përfshin një bashkëveprim kompleks midis predispozicioneve evolucionare dhe faktorëve gjenetikë dhe socio - kulturor. Edukimi i aftësive sociale dhe emocionale është po aq i rëndësishëm sa edhe ndaj kujdesit fizik. Studime të ndryshme tregojnë lidhjen e cila ekziston midis aktivitetit fizik dhe psiko - motor, të njohur si shoqëror dhe zhvillim emocional.

Mungesa e kujdesit nga ana e prindërve sjell pasoja negative, të cilat vazhdojnë të shtjellohen gjithnjë e më rritje në shkollë. Për mësimdhënësit, një nga sfidat e tyre më të mëdha është mbështetja e fëmijëve të vegjël që kanë sjellje problematike përtej asaj që mund të pritët. Disa fëmijë përfshihen në sjellje problematike që është tipike për një fazë të veçantë të zhvillimit ndërsa ndërtojnë marrëdhënie me moshatarët dhe të rriturit dhe mësojnë të lundrojnë në mjedisin e klasës.

Hulumtimi konkludon që rreth 86%, ndikimi i rrethit shoqëror, niveli i arsimit të prindërve, gjendja ekonomike janë faktorët kryesor të cilët ndikojnë në zhvillimin e aftësive

sociale dhe emocionale. Fëmijët duhet të përjetojnë prindërit e tyre si mbështetës dhe mirëkuptues dhe se ata duhet të ndiejnë se kanë një farë shkalle kontrolli mbi veprimet e tyre në mënyrë që të kenë zhvillim të aftësive sociale dhe emocionale. Mësimdhënësit duhet kushtuar rëndësi të veçantë mënyrës së zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale duke përdorur strategji të duhura për zhvillimin e tyre dhe mësimet t'i bazojnë në mësim me qëllim që nxënësit të përgatiten edhe për jetën jashtë shkollore. Gjithashtu vie në përfundim që hipotezat qëndrojnë bazuar në të dhënat e mbledhura nga pyetësorët e realizuar me mësimdhënësit e shkollave të Kosovës. Aftësitë sociale dhe emocionale janë një mbështetje në përgatitjen e nxënësve për një rregullim dhe funksionim shoqëror të suksesshëm në jetë dhe shumica e mësimdhënësve në shkollat fillore përmes metodave efikase si gjithpërfshirja sociale dhe ndërveprimeve shoqërore ofrojnë një zhvillim adekuat të aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve, me qëllim që ata të përshtaten dhe pranohen nga të tjerët.

4.2 Përmbledhje e rekomandimeve

- Në bazë të rezultateve të arritura nga ky hulumtim rekomandoj se:
 - Duhet të rritet interesimi i prindërve, edukatoreve dhe mësimdhënësve për zhvillimin adekuat të aftësive sociale – emocionale të nxënësve.
 - Duhet të organizohen lojëra dhe aktivitete të tjera me qëllim të zhvillimit të aftësive sociale – emocionale të nxënësve,
 - Tu kushtohet kujdes përdorimit dhe përzgjedhjes së metodave dhe teknikave më të reja të mësimdhënies me qëllim të zhvillimit të aftësive të nxënësve,
 - Të punohet dhe të zhvillohet një mësimdhënie bashkëkohore bazuar në ato njohuri që janë të rëndësishme për nxënësit dhe që i përgatitin për jetë.

Referenca

- New Brunswicker. (2008). Gjetur në What is social development?:
https://www2.gnb.ca/content/gnb/en/departments/esic/overview/content/what_is_social_development.html
- Udhëzime për mësimdhënësit për gjithëpërfshirjen sociale të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në shkolla.* (2015). Prishtinë: Supporting Access to Education and Intercultural Understanding.
- (2017, July 29). Gjetur në Committe for children: <https://www.cfchildren.org/what-is-social-emotional-learning/>
- (2021, April 15). Gjetur në MentalUp: <https://www.mentalup.co/blog/social-and-emotional-skills-in-children>
- Albana Markja, Dr. Marina Ndrio, Prof. Dr. Edmond Dragoti, Prof. Asoc. Irida Agolli. (2015). Profili i mësuesit gjithëpërfshirës. Në A. M. Ibana Markja, *EDUKIMI DHE FORMIMI I MËSUESVE PËR GJITHËPËRFSHIRJEN* (f. 6). Tiranë: UNICEF.
- Alikaj, I. (2018, Prill 16). *Aftësitë e zhvillimit social-emocional*. Gjetur në Psikologjia:
<http://revistapsikologji.com/nga-imo-alikaj-aftesite-e-zhvillimit-social-emocional/>
- Andrijana Tasevska, G. M. (2017). *PËRKRAHJA NXËNËSVE ME VËSHTIRËSI NË MËSIM*. Shkup: UNICEF.
- Arjan Kamburi, O. B. (a.d.). *Zhvillimi dhe edukimi i fëmijëve 0-3 vjec*. Shqipëri: Save The Children.
- Bajrami D., Shabani A. (2019, September 12-14). The Role of Multicultural Education and Social Media in the Affirmation of Democratic Society. *ENTRENOVA* (f. 262). Croatia: ENTRENOVA.
- Bërçulli, M. D. (2017). Psikologjia. Në *Psikologjia sociale* (f. 113).
- Brada, R. (2010). Cështjet e përgjithëshme të menaxhimit të mësimit. Në R. Brada, *Didaktika Kibernetike* (f. 383). Pejë: Dukagjini.
- Clarke, A., Morreale, S., Field, C., Hussein, Y., & Barry. (2015). What works in enhancing social and emotional skills? *NUI Galway*, 16.
- Dubey, A. k. (2017). *Personality Development*. 23 September.
education, o. a. (a.d.).
- Eredics, N. (2018, January 26). *10 Things You Can Do to Make Your Class Socially Inclusive*. Gjetur Janary 26, 2018, nga The Inclusive Class with Nicole Eredics:
<http://www.theinclusiveclass.com/2018/01/10-things-you-can-do-to-make-your-class.html>
- Erleta Mato, P. K. (2003). *Parashkollori*. Tiranë: Botim i institutit të studimeve pedagogjike.

- Florina Shehu, S. P. (2014). *Zbatimi i standardeve për zhvillim të hershëm*. Shkup: UNICEF.
- Florina Shehu, Simona Pallçevska, Antinulla Niçova, Valentina Zindl, Brankica Mladenovik, Biljana Ançevska, Nadica Janeva. (2014). *Zbatimi i standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm*. Gjetur në <https://www.unicef.org>:
https://www.unicef.org/tfymacedonia/Priracnik_za_vospituvaci_0-6_-_ALB_-_ZA_WEB.pdf
- Gerti Janaqi, A. Z. (2015). *Standardet e zhvillimit dhe të të nxënimit të fëmijëve 3-6 vjeç*. Shqipëri: Unicef.
- Gerti Janaqi, A. Z. (2016). *Standardet e zhvillimit dhe të të nxënimit të fëmijëve 3-6 vjeç*. Shqipëri: Unicef.
- Gosala, J. (2019). Importance of personality development in a student's life. *The Hansa India*.
- Hans News Servic. (a.d.). *Hans News Service*.
- Haskovic, M. (2006). *Psikologjia*. Sarajevë: Tetor.
- Hoti, A. (2012). *Psikologjia e personalitetit*. Tiranë.
- Inge Zweers, R. A. (2020). Social–emotional development of students with social–emotional and behavioral difficulties in inclusive regular and exclusive special education. *SAGA Journals*, 59.
- Institutit të Zhvillimit të Arsimit , UNICEF. (2015). *Standardet e zhvillimit dhe të të nxënimit të fëmijëve 3-6 vjeç*.
- Jashari, H. (2005). *Sociologjia e arsimit*. Shkup: Interlingua.
- Kosovo, S. t. (2017). protection_and_development_eccd. f. 4.
kosovo.savethechildren.net. (a.d.).
- Kraja, . (1998). *Pedagogjia*, Tiranë.
- Laraformm*. (a.d.). Gjetur në <https://sq.laraformm.com/process-childs-emotional-development-5882>
- Lena Damovska, F. S. (2008). STANDARDET PËR MËSIM DHE ZHVILLIM TË HERSHËM TE FËMIJËT NË MOSHË PREJ 0 - 6 VJEÇ. Në *Zhvillimi i hershëm i fëmijëve* (f. 27). Maqedonia: UNICEF.
- Lise Fox, R. H. (2006, Nowember). "You Got It!" Teaching Social and Emotional Skills". *Young Children*, f. 3.
- Lovins, J. (2018). 3 Ways to Help Educators Develop Social Emotional Skills. *Getting Smart*.
- MASHT. (2011, Tetor 01). *Standardet e zhvillimit dhe të mesuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet*. Gjetur Tetor 01, 2011, nga <http://masht.rks-gov.net>: http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/elds-report-alb-for-web_1.pdf
- Murtezani, D. L. (2014). *PSIKOLOGJIA*. Cabej: Tetovë.

- Musa Kraja, G. D. (2017). Psikologji. Në *Seria e shkencave të edukimit* (f. 22). Shkodër: Buletini shkencor.
- Musai, B. (2014). *Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë: CDE.
- Neal, J. W. (2020). Social Development. *Wiley Online Library*.
- OECD. (2021). *First Results from the Survey of Social and Emotional Skills*. Paris: OECD.
- Orhani, Z. (2011). *Psikologjia e emocioneve*. Tiranë: Shtypshkronja "Vllamasi".
- Përlala, P. A. (2008). *Psikologjia e edukimit*. Tiranë: Shtëpia Botuese "Ufo Press".
- Pettijohn, T. F. (1996). *Psikologjia*. Tiranë: Shtëpia botuese "Lilo".
- Prof.asoc.dr.Illir Kelmendi, P. G. (2018, Mars 28). Zhvillimi psiko sociale dhe emocional i fëmijëve dhe inkuadrimi i tyre në punë. f. 14.
- Profka, I. A. (2017, May 09). *Zhvillimi emocional te fëmijët*. Gjetur në BEPUZZLE:
<http://bpuzzle.blogspot.com/2017/05/zhvillimi-emocional-te-femijet-i-alikaj.html>
- Save The Children. (2017). *Fëmijëria e hershme: Promovimi i sigurisë dhe zhvillimit socio-emocional të fëmijës*. Save The Children Kosovo.
- Shabani A., Bajrami D. (2019). The Impact of Campus Interaction Among Students in Enriching Student Learning Experiences in North Macedonia. *ENTRENOVA* (f. 258). Croatia: IRENET - Society for Advancing Innovation and Research in Economy.
- Shehu,F. Pallçevska,S. (2014). *www.unicef.org*. Gjetur 03 08, 2018, nga *www.unicef.org*:
https://www.unicef.org/tfyrmacedonia/Priracnik_za_vospituvaci_0-6_-_ALB_-_ZA_WEB.pdf
- Simply Psychology. (2016). <https://www.simplypsychology.org>. Gjetur në Bandura - Social Learning Theory: <https://www.simplypsychology.org/bandura.html>
- Ulrike Wol -Jontofsohn, H. Z.-H. (2015). *Udhëzime për mësimdhënësit për gjithëpërfshirjen sociale të romëve,ashkalive dhe egjiptianëve në shkolla*. Prishtinë: Supporting Access to Education and Intercultural Understanding.
- Zhurda, Y. (2009). Psikologjia. Në Y. Zhurda, *Psikologjia* (f. 299). Tiranë: Shtëpia botuese e librit universitar.

Shtojca:

Pyetësi

Të nderuar mësues!

Pyetësi që keni para jush ka për qëllim të njoh perspektivën tuaj rreth aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve. Rezultatet e të cilit do të shfrytëzohen si pjesë e hulumtimit tim për tezën e masterit në programin “Menaxhimi dhe udhëheqja në arsim”. Të dhënat e mbledhura do të mbeten konfidenciale, andaj ju lus që të përgjigjeni me sinqeritet dhe përgjigjet të paraqesin mendimin tuaj të vërtetë!

1. Gjinia:
 - Mashkull
 - Femër

2. Moshë:
 - 18-25 vjeç
 - 26-35 vjeç
 - 36-50 vjeç
 - Mbi 50 vjeç

3. Niveli arsimor:
 - Bachelor
 - Master

4. Vendi ku punoni:
 - Urban
 - Rural

5. Përvoja juaj e punës në mësimdhënie:

- 1 – 5 vjet
- 6 – 10 vjet
- 11 – 15 vjet
- Mbi 15 vjet

1. Gjatë shkollimit të juaj, njohuritë e marra për personalitetin, zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve janë në nivelin e duhur!

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem pjesërisht
- Neutral
- Nuk pajtohem

2. Formimi i personalitetit të shëndoshë të nxënësve është i lidhur ngushtë me zhvillimin social dhe emocional të tyre.

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem pjesërisht
- Neutral
- Nuk pajtohem

3. Hapat e parë të zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve merren në familje.

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem pjesërisht
- Neutral
- Nuk pajtohem

4. Zhvillimi i aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve varet nga faktorë të ndryshëm si gjenetika, rrethi familjar, rrethi shoqëror, kultura, edukimi.

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem pjesërisht
- Neutral
- Nuk pajtohem

5. Zhvillimi i aftësive sociale – emocionale të nxënësve në shkollë varet nga metodat që përdorin mësuesit/et për zhvillimin e tyre.

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem pjesërisht
- Neutral
- Nuk pajtohem

6. Për të zhvilluar aftësitë sociale – emocionale është e rëndësishme të përdorim strategji të duhura sepse çdo nxënës është unik.

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem pjesërisht
- Neutral
- Nuk pajtohem

7. Format më të parapëlqyera për zhvillimin e aftësive sociale – emocionale janë puna në dyshe dhe në grupe.

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem pjesërisht
- Neutral
- Nuk pajtohem

8. Nxënësit me aftësi të pazhvilluara sociale - emocionale kanë vështirësi të krijojnë shokë të riinjë dhe të integrohen në shoqëri.

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem pjesërisht
- Neutral
- Nuk pajtohem

9. Zhvillimi i mirëfilltë i aftësive sociale – emocionale e ndihmojnë nxënësin të përgatitet edhe për jetën jashtë shkollore.

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem pjesërisht
- Neutral
- Nuk pajtohem

10. Të mësuarit përmes lojës nxit zhvillimin e aftësive tek nxënësit.

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem pjesërisht
- Neutral
- Nuk pajtohem

11. Fëmijët zhvillojnë aftësi pozitive sociale – emocionale në bashkëveprim me moshatarët dhe të rriturit.

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem pjesërisht
- Neutral
- Nuk pajtohem

12. Gjatë procesit të socializimit dhe bashkëpunimit fëmijët ndjehen pjesë e shoqërisë.
- Pajtohem plotësisht
 - Pajtohem pjesërisht
 - Neutral
 - Nuk pajtohem
13. Gjithpërfshirja sociale ndikon në klimën pozitive brenda klasës dhe bënë që nxënësit të përjetojnë progres gjatë zhvillimit të tyre.
- Pajtohem plotësisht
 - Pajtohem pjesërisht
 - Neutral
 - Nuk pajtohem
14. Gjatë punës me nxënës, drejtuar zhvillimit të aftësive të tyre ndihmohemi edhe nga pjesa tjetër e aktivitetit të shkollës (psikologu, pedagogu, mësuesi ndihmës).
- Pajtohem plotësisht
 - Pajtohem pjesërisht
 - Neutral
 - Nuk pajtohem
15. Bashkëpunimi mësues - prindër është çelësi i suksesit për zhvillimin e aftësive sociale – emocionale dhe të arriturave të tjera të nxënësve!
- Pajtohem plotësisht
 - Pajtohem pjesërisht
 - Neutral
 - Nuk pajtohem